

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZGJEDHJET PARLAMENTARE
25 Qershor 2017

**Raporti monitorues 2-vjeçar
mbi Situatën e Krimet Zgjedhor**



Tiranë, 28 Prill 2019

Seria e Studimeve dhe Botimeve nga
Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP
2019

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Materiali që përmban ky publikim nuk mund të kopjohet apo riprodhohet në asnjë rrethanë. Të dhënat që përmban ky raport mundet vetëm të citohen me kusht që të njihet/citohet autorësia e tij përmes referimit të plotë në tekst të attributeve të autorit. Një kopje e publikimit që përmban materialin e referuar duhet t'i dërgohet INFOÇIP në adresën qendra@infocip.org

Çdo përdorim i parashtrimeve teorike apo i gjetjeve që përmban ky studim, pa leje dhe/ose nga të tretë është i ndaluar dhe subjekt penalizimi nga legjislacioni në fuqi për të drejtën e autorit .

Drejtor i projektit:

Gerti Shella

Konsulent:

Endrit Shabani

Researchers/ monitors

Dao Zela

Donaltina Vila

Altea Krajka

ICT system/database

Dritjon Selmani

Hartuar për vitin 2018-2019 nga Qendra për Çështje të Informimit Publik :



Disclaimer:

Gjetjet, rekomandimet dhe opinionet e shprehura në këtë studim, nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të donatorit apo sponsorizuesit të këtij studimi, por vetëm ato të autorëve

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

INFOCIP monitoroi situatën e krimit zgjedhor në Zgjedhjet Parlamentare të mbajtura në 25 Qershor 2017. Ky lloj monitorimi realizohet për herë të parë në historinë e zgjedhjeve në Shqipëri dhe cakton një gur themeli në këtë drejtim.

Raporti monitories i hartuar vlerëson incidencën dhe hetimin nga Prokuroria të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Këto vepra penale (shkurt: krim zgjedhor) janë parashikuara në Kreun X të Kodit Penal të RSH. Si rezultat i marrveshjes PS-PD të 18 Majit 2017, Kreu X i Kodit Penal pësoi ndryshime, të cilat u miratuan në seancë të jashtëzakonshme plenare në 22 Maj 2017, duke hyrë në fuqi menjëherë.

Koha që mbulon monitorimi fillon nga momenti zyrtar i hapjes së fushatës në 29 Maj 2017 dhe përfundon në 31 Dhjetor të vitit 2018. Të dhënat e grumbulluar gjatë kësaj periudhe 20-mujore u rakorduan në Prill 2019. Intervali i rakordimeve ka qënë çdo tre muaj, në analogji me kohën e afateve të hetimit që ka në dispozicion organi i Prokurorisë. Monitorimi ndahet në dy faza metodologjike sa i takon incidencës dhe hetueshmërisë së krimit zgjedhor:

- *Faza e parë përfshin fushatën e zgjedhore, ditën e votimit si dhe periudhën pas-zgjedhore të numërimit të votave dhe shpalljes së rezultateve deri në Korrik 2017.*
- *Faza e dytë përfshin kohën në të cilën kallzimet penale dhe procedimet e tjeratë referuara hyjnë në ciklin e hetimit nga ana e Prokurorisë.*

Objekt monitorimi në fazën e parë është incidence e veprave penale të parashikuara nga Kreu X i Kodit Penal të ndryshuar, kurse objekt monitorimi në fazën e dytë është hetueshmëria dhe ndëshkueshmëria e këtyre veprave penale.

Nga 21 prokurori të rretheve gjyqësore të monitoruara nga INFOCIP për dy vite rrjesht, raporti konstaton sa më poshte vijon:

- 1. Gjatë vitit 2017 u regjistruan gjithsej 64 çështje për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira. Prej tyre, vetëm 6 u hetuan plotësisht dhe iu dërguan gjykatës ndersa 9 u pushuan. Nën hetim ishin ende 49 dosje (PP) deri në fund të 2017.**
- 2. Gjatë vitit 2018, nga 49 çështje të mbartura nga 2017, iu drejtuan gjyqit 2 çështje, 18 procedime penale u pushuan dhe 1 u pezullua.**
- 3. Viti 2019 nisi me 28 dosje penale ende në hetim nga organi i Prokurorisë për vepra të cilat bien në parashikimet e kreut X të Kodit Penal të ndryshuar.**

Një raport i ndërmjetëm mbi incidencën e krimit zgjedhor dhe pushimet e padrejta nga puna u bë publik në datë 24 Qershor 2017 (ditë e shtunë, që përkon me ditën e heshtjes zgjedhore). Lidhur me periudhën post-zgjedhore, e cila përbën 80% të kohë-shtrirjes së këtij monitorimi, INFOCIP ka bërë publike dy raporte deri më tani. Raporti i fundit u shpërnda në datë 18 Prill 2018¹. Rreth një vit pas marrveshjes së 18 Majit 2017, INFOCIP konkludoi se, nga 64 Procedime Penale të regjistruara në Organin e Prokurorisë, vetëm 6 prej tyre ishin hetuar plotësisht nga Organi i Akuzës dhe/ose i ishin dërguar më pas gjykatës për vendimarrje të mëtejshme.

¹ <http://www.infocip.org/al/?p=12889>

Për shkak të numrit të lartë të procedimeve ende nën hetim në fund të vitit 2017, rreth 49 të tilla, INFOCIP e kondideroi të domosdoshme të vijonte me një vit më shumë monitorimin e situatës së hetueshmërisë të veprave penale që çënojnë sistemin demokratik të zgjedhjeve. Periudha e shtesë e monitorimit dhe vlerësimit përfshiu gjithë vitin 2018. Të dhënat e vitit 2018 u analizuan me muajin Mars 2019 dhe rakorduan plotësisht në muajin Prill 2019. INFOCIP analizoi në tërësi të gjitha të dhënat statistikore nga 21 prokurori rrethesh, duke i kontrastuar ato me të dhënat e raportuar në Prokurorinë e Përgjithshme.

Përmes gjetjeve të këtij Monitorimi testohet cilësia e ndryshimeve në Kreun X të Kodit Penal, rezultat direkt i Marrveshjes Politike të 18 Majit 2017. Implementuesit e drejtpërdrejtë të ndryshimeve ligjore të realizuara ishin dy aktorët politike vendimarrës, PS dhe PD, njëkohësisht edhe subjekte zgjedhore që cilët garuan përballë njëri-tjetrit në zgjedhjet e fundit parlamentare. Ajo që e bën të veçantë këtë monitorim është fakti se PS dhe PD bashkëqeverisën vendin në periudhën zgjedhore dhe ishin në pozitat optimale për të realizuar një implementim rigoroz të ndryshimeve që vetë ata ndërmorën në Kodin Penal të RSH.

Gjetjet e monitorimit caktojnë gjithashtu një terren solid për të vlerësuar punën dhe performancën e organit të Prokurorisë, që ka detyrë funksionale të administrojë kallzimet penale dhe të orientojë hetimin. Përmes evidencave zyrtare të disponuara nga Prokuroria, INFOCIP ka përlloritur raportin mes veprave penale të kallzuara dhe atyre të dërguara për gjykim. Kjo analizë e bazuar mbi evidence, ekspozon për herë të parë qasjen e Prokurorisë ndaj zbatimit të normës ligjore (Kreu X, KP i ndryshuar).

Po ashtu, gjetjet e këtij Raporti vlerësojnë edhe implemetimin e qëllimeve të ligjvënësit (Kuvendit) i cili ashpërsoi dënimet për veprat penale që çënojnë zgjedhjet demokratike.

Së treti, gjetjet e raportit janë një pasqyrë vlerësimi për punën e Qeverisë shqiptare në disa dimensione, duke filluar që nga marrja e masave për parandalimin e krimit zgjedhor e deri tek aktivizimi i mekanizmit të kallzimeve penale në kohë zgjedhore. Një pjesë e këtyre kallzimeve u aktivizuan direkt nga ministrat teknikë. Sa i takon qeverisë, pushime nga puna apo rekrutimet në punë në kohë fushatë janë një problematikë që gjithashtu gjen pasqyrim në këtë raport të INFOCIP.

Për hartimin e këtij raporti INFOCIP përdori të dhëna nga shtatë burime kryesore:

1. *Media (TV, Gazeta, Portale)*
2. *Të dhënat e Policisë së Shtetit*
3. *Të dhënat e partitë politike, subjekte zgjedhore në kohë zgjedhjesh.*
4. *Raporti Zyrtar i Ministrave teknikë.*
5. *Raporti i KQZ për procesin e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare 2017*
6. *Të dhënat zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, përmes kërkesës për informim*
7. *Të dhënat zyrtare të Prokurorive të rretheve*

Në fazën e parë të hartimi të këtij raporti, gjetjet janë dokumentuar kryesisht nga një triangulum burisht që konsistojnë në: a) *Komunikatat zyrtare të Policisë*; b) *Njoftimet në media të subjekteve zgjedhore*; c) *Komunikimet zyrtare të ministrave (politike dhe teknikë)*. Dokumentimi i të dhënave në fazën e parë është bërë në mënyrë sistematike në Portalin e krijuar nga INFOCIP për këtë qëllim: ëëë.krimizgjedhor.com

II. GJETJET KRYESORE - Viti 2017

1. Gjatë periudhës zgjedhore për zgjedhjet Parlamentare të 25 Qershorit 2017, Media raportoi rreth **140 raste të veprave penale** që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në kreun X të Kodit Penal. Shumica e rasteve, **rreth 111**, përkojnë me periudhën e fushatës zgjedhore dhe ditën e votimit.
2. Ministri teknik i Punëve të Brendshme raportoi për **484 denoncime** pranë organit të Policisë që lidhen me vepra të ndryshme penale². Ai i kerkoi Policisë së Shtetit t'i adresojë në organin e Prokurorisë për procedim penal denoncimet e depozituara.
3. Policia e Shtetit raportoi zyrtarisht se pranë drejtorive rajonale/degëve të saj në gjithë Shqipërinë u denoncuan **69 raste** të cilat klasifikohen si vepra penale të parashikuara nga Kreu X i Kodit Penal dhe për të cilat materialet i kaluan Prokurorisë. Kjo përbën vetëm 1/7 e rasteve të referuara nga Ministri i Brendshëm (teknik). Mos-përkimi i shifrave midis Ministrisë të Brendshme nga njëra anë dhe Policisë së Shtetit nga ana tjetër shihet si një problem serioz në administrimin e krimit zgjedhor në Zgjedhjet Parlamentare të Qershorit 2017.
4. Në raportin zyrtar³ që mban logon e Kryeministrit dhe që është firmosur nga zv. kryeministria teknike, Znj. Ledina Mandija, rezulton se në Prokurori u referuan gjithsej **190 raste në total** (përfirë këtu edhe denoncimet e referuara nga Policia në Prokurori) për vepra që kanë të bëjnë me krimin zgjedhor, të parashikuara nga Kreu X i Kodit Penal, të ndryshuar. Këto raste përkojnë me 190 persona të cilat janë të identifikuar nominalisht në raportin final të task-force, të bërë publik në periudhën Gusht-Shtator 2017⁴.
5. Nga totali prej **190 rastesh** të cilat iu referuan prokurorisë, rreth 45 kallzime janë firmosur për punonjës që kanë qënë në varësi juridiksionale direkte të ministrave teknike, përfshirë zv. Kryeministres Teknike, Znj. Ledina Mandija.
6. Në zgjedhjet parlamentare të 25 Qershorit 2017, objekt kallzimi penal u bënë si asnjëherë më parë edhe funksionarët më të lartë të qeverisjes qendrore dhe vendore, mes të cilëve, kryeministri i vendit, kryetari i bashkisë Vlorë dhe Kamëz, ministra teknike, kandidatë për deputetë (qarku Berat) etj. Ndër kallzimet apo paditë administrative të depozituara nga funksionarë të administratës apo subjekti zgjedhor PS, mund të përmendet ai ndaj ministres teknike të Arsimit dhe Sportit.
7. KQZ është institucioni që depozitoi numrin më të madhe të kallzimeve penale në periudhën post-zgjedhore. Rreth 76 persona që sipas KQZ konsumuan vepra penale të

² Raporti i MPB, shkresa nr. 547411, date 10.07.2017, faqe 1 dhe 2

³ <https://drive.google.com/file/d/0B5i0S7hBf0qrWWxoVFJSSVBoLTNpQUdVa05kclFTQjNYV2s0/view>

⁴ Fq 89-110 <https://drive.google.com/file/d/0B5i0S7hBf0qrWWxoVFJSSVBoLTNpQUdVa05kclFTQjNYV2s0/view>


cilat cënonin zgjedhje u kallzuan penalisht prej saj. Pjesa dërmuese e kallzimeve u depozitua në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për shkak të kompetencës tokësore. Më pas, çështjet janë bashkuar në dosje hetimore, sipas specifikës së veprës penale të referuar. Neni 326/1 rezulton të këtë patur numrin më të lartë të personave të proceduar, bashkuar në **15 procedime penale gjithsej**.

8. Sipas të dhënave të Prokurorisë së Përgjithshme, dhe të prokurorive të rretheve, të disponuara në rrugë zyrtare nga INFOCIP, rezulton se, deri në 31 Dhjetor 2017, u regjistruan në prokuroritë e rretheve 64 procedime penale në total, për vepra të parashikuara në Kreun X të Kodit Penal të RSh, të ndryshuar.
9. Në total, për vitin 2017, sipas dhënave të disponuara nga organi i Prokurorisë, numri i të pandehurve për 64 procedime penale të regjistruara, ka qene 98. Ky numër duhet marrë gjithsesi me rezervë, në kushtet kur sistemi i dokumentimit të të dhënave statistikore nga organi i Prokurorisë është trivial dhe jo i unifikuar.
10. Nga 64 procedime të regjistruar në organin e akuzes për vepra penale të krimit zgjedhor në vitin 2017, vetëm 6 prej tyre u hetuan tërësisht dhe u dërguan në gjykatë. Kjo përbën rreth 9 % të totalit të çështjeve penale të regjistruara sa i takon cënimit të sistemit demokratik të zgjedhjeve(kreu X i KP, të ndryshuar).
11. Në vitin 2017, organi i Prokurorisë arriti të përfundonte hetimet vetëm për 6 procedime penale që binin në parashikimet e Kreut X të Kodit Penal të Ndryshuar.
12. Për 49 procedime të tjera penale të depozituara, hetimet nuk u përmbyllën dot brenda vitit 2017. Organi i Prokurorisë pushoi 9 procedime penale për mungesë provash ose mos-konstatim të konsumimit të veprës penale në vitin 2017.
13. Prokuroria me numrin më të lartë të kallzimeve penale të regjistruara ishte ajo e Tiranës me 27 procedime penale gjithsej në vitin 2017, e ndjekur nga Elbasani (10), Kukësi (5) dhe Korça (4).
14. Rrethet gjyqësore në të cilat nuk u shënuar asnjë kallzim penal gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentar janë Saranda, Pogradeci, Përmeti, Kruja dhe Kurbini.

III. GJETJET KRYESORE - Viti 2018

1. Në vitin 2018, organi i prokurorisë nisi punën me 49 procedime penale ende nën hetim në shkallë vendi, për veprave penale që prekin sistemin demokratik të zgjedhjeve. Procedime penale mund të jenë mbartur nga viti 2017, sa kohë që vetë viti 2018 nuk ishte një vit zgjedhor. Këto 49 procedime përfaqësojnë 77% të totalit të çështjeve penale të regjistruara sa takon zgjedhjeve më të fundit (të vitit 2017).

2. Në vitin 2018, organi i prokurorisë përmbylli hetimet dhe dërgoi dosjen penale në gjykatë për vendimarrje të mëtejshme vetëm për vetëm 2 dosje që binin në parashikimet e Kreut X të KP, të ndryshuar. Procedimet penale të hetuara që iu dërguan gjyqit i përkasin respektivisht prokurorive të rretheve Durrës dhe Kavajë.
3. Po ashtu, në vitin 2018, organi i Prokurorisë pushoi edhe 18 çështje të tjera penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të rregjistruara në zgjedhjet e fundit. Numrin më të madh të vendimeve të pushimit e ka Prokuroria e Tiranës me 17 të tilla, pasuar nga ajo e Pukës, me 1 çështje të pushuar në vitin 2018.
4. Në vitin 2018, rezulton vetëm 1 çështje penale e pezulluar, e cila bie në parashikimet e Kreut X të KP të ndryshuar. Kjo çështje i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
5. Në fund të vitit 2018, rezultoi se kishin ngelur ende 28 çështje/procedime penale nën hetim nga ana e organit të akuzës. Kjo përfaqëson 44% të totalit të çështjeve penale që u regjistruan në organin e Prokurorisë gjatë vitit 2017 për vepra penale që çënojnë zgjedhjet demokratike.
6. Numrin më të lartë të procedimeve ende nën hetim deri në fund të vitit 2018 rezulton ta ketë Prokuroria e rrethit gjyqësor Elbasan, me 9 tilla, e ndjekur nga ajo e Tiranës me 4 dosje ende nën hetim.
7. Në vitin 2019, organi i prokurorisë ka mbartuar rreth 28 procedime penale nga zgjedhjet e fundit parlamentare. Mund të thuhet se për këto 28 procedime, afatet e hetimit janë zgjatur 6 herë me nga 3 muaj (mesatarisht).



Prokuroria e Rrethit Gjyqësor	2017					2018				
	Proc. të reja të regjistruara	Gjyq	Pushuar	Pezulluar	Mbetën nën hetim	Proc. të reja të regjistruara	Gjyq	Pushuar	Pezulluar	Mbetën nën hetim
Tirane	27	4	2		22 ⁵	0	0	17	1	4
Berat	2	0	0	0	2	0	0	0	0	2
Diber	2 ⁶	0	0	0	2	0	0	0	0	2
Durres	2	0	0	0	2	0	1	0	0	1
Elbasan	10 ⁷	1	0	0	9	0	0	0	0	9
Sarande	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pogradec	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Permet	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kruje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kurbin	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjirokaster	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lushnje	2	0	0	0	2	0	0	0	0	2
Mat	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Kavaje	2	0	1	0	1	0	1	0	0	0
Tropoje	2	0	0	0	2	0	0	0	0	2
Puke	1	0	1	0	1	0	0	1	0	0
Shkoder	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fier	1	0	0	0	1	0	0	0	0	1
Kukes	5	0	4	0	1	0	0	0	0	1
Lezha	3 ⁸	0	0	0	3	0	0	0	0	3
Korce	4	2	0	0	2	0	0	0	0	2
Total	64	6	9	0	49⁹	0	2	18	1	28

⁵ Shih shpjegimet në paragrafin 16 të Përmbledhjes Ekzekutive.

⁶ Shih shpjegimet në paragrafin 18 të Përmbledhjes Ekzekutive.


⁷ Shih shpjegimet në paragrafin 17 të Përmbledhjes Ekzekutive.

⁸ Shih shpjegimet në paragrafin 18 të Përmbledhjes Ekzekutive.

⁹ Jane 49 procedime penale ende nën hetim në 2017, u mbartën në vitin 2018.

Nga **21** prokurori të rretheve gjyqësore te monitoruara dhe të analizuara, konkludohet se:

- Gjatë vitit 2017 u regjistruan gjithsej **64** çështje për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira, prej tyre **6** u drejtuan gjyqit ndersa **9** u pushuan, në gjykim mbetën **49** në fund të 2017.
- Gjatë vitit 2018 nga 49 çështje të mbartura nga 2017 u drejtuan gjyqit **2** çështje, **18** u pushuan dhe **1** pezullua. Në fund të 2018 mbetën në gjykim ende **28** çështje.



IV. TË DHËNA TË TJERA, VITET 2017-2018 (në rend kronologjik)

1. Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2017, numri më i lartë i veprave penale u regjistrua për shkelje të nenit 328 “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”¹⁰, me 24 procedime të regjistruara deri në 31 Dhjetor 2017. Prej këtyre, deri në fund të vitit 2017 ishin pushuar nga prokurorite e rretheve 11 procedime penale.
2. Një numër relativisht të lartë procedimesh të regjistruara pati edhe për veprat penale të parashikuara nga neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”¹¹. Sipas të dhënave të vënë në dispozicion nga Prokuroria e Përgjithshme, deri në fund të vitit 2017 rezultonin të regjistruara 14 procedime penale prej të cilave 7 ishin pushuar kurse 7 të tjera ishin ende në hetim.
3. Në Prokurorinë e Tiranës, u depozituan kallzime për 55 persona (15 procedime gjithsej), për vepra penale të parashikuara nga neni 326 dhe 326/a i Kodit Zgjedhor. Prej tyre, deri në fund të vitit të 2017, u pushuan 9 procedime penale me 32 persona të kallzuar ndërkohë që në vitin 2018 u mbartën 6 procedime penale me 23 persona gjithsej nën hetim (shih më poshtë).

¹⁰ Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017

¹¹ Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017

V. TË DHËNA MBI PROKURORITË E RRETHEVE

1. Ndër prokuroritë e rretheve gjyqësore, ajo e Tiranës ka administruar më shumë kallzime penale krahasuar me prokuroritë e tjera. Ky fakt mund të shpjegohet me juridiksionin lëndor që ky organ ka për institucionet qëndrore që janë të përfshira direkt apo indirekt në administrimin e procesit zgjedhor.
2. Vetëm për Prokurorinë e Rr.GJ. Tiranë, në fund të vitit 2017 rezultoi 27 procedime penale të regjistruara, për vepra që lidhen me krimin zgjedhor, prej të cilave dy janë pushuar, për një është marrë vendim mosfillimi, 4 iu dërguan gjykatës dhe pjesë tjetër, 21 gjithsej, vijuan të mbeten nën hetim.
3. Numri më i lartë i kallzimeve nga ana e KQZ në Prokurorinë e Tiranës ka të bëjë me veprën penale të parashikuar nga neni 321/1 “Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve”, për të cilën, vetëm në Prokurorinë e Tiranës u vendosën nën hetim 55 të pandehur të shpërndarë në 15 procedime penale (verifikimi i datës 15 Prill 2018). Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kallzimeve janë bërë nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, KQZ.
4. Në Prokurorinë e Rrethit Tiranë shifrat statistikore të përpunuar sugjerojnë se deri në fund të vitit 2017 ishin nën hetim/procedim 60 persona për vepra penale të pashikuara nga kreu X i Kodit Penal të ndryshuar në datë 22 Maj 2017.
5. Sipas të dhënave zyrtare të Prokurorisë së Tiranës, viti 2018, nisi me 22 procedime penale. Kjo shifër zyrtare nuk përkon me atë të raportuar në raportin vjetor 2017 nga vetë Prokuroria e Tiranës. Një shpjegim i mundshëm mund të jetë se në vitin 2018 mund të jetë rregjistruar një çështje e re penale që bie në parashikimet e kreu X të Kodit Penal të ndryshuar. Një tjetër shpjegim mund të jetë se, gjatë vitit 2017, gjyqit ju dërguan vetëm 3 çështje penale, dhe jo 4 sikurse ka raportuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për efekt të këtij Raporti, do të referohet shifra zyrtare e raportuar, pra ajo e **22** procedimeve penale të mbartuara/nisura në 2018-ën.
6. Prokuroria e rrethit Gjyqësor Elbasan raportoi zyrtarisht se në vitin 2017 janë rregjistruar 10 procedime penale për krime që çënojnë rendin demokratik të zgjedhjeve¹². Kjo shifër referohet edhe në Raportin Vjetor të saj për vitin 2018¹³. Raportet zyrtare të prodhuara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan janë të formuluar me inkoherenca. Tabelat e paraqitura nuk përkojnë me shifrat e referuara me shkrim në Raport. Ky është një tregues tjetër i punës jo-profesionale të Prokurorisë gjyqësore në dokumentimin dhe raportimin e incidencës së krimit zgjedhor (shih rekomandimet më poshtë).

¹² Shih faqen 8 të Raportit Zyrtar Vjetor

http://www.pp.gov.al/web/elbasan_raporti_vjetor_2017_1326.pdf

¹³ Shih faqen 81 të Raportit Zyrtar Vjetor http://www.pp.gov.al/web/elbasani_analiza_2018_1469.pdf

7. Të tjera prokurori rrethesh, të cilat kanë raportuar shifra jo-koherente në raportet e tyre zyrtare janë edhe ato të Lezhës dhe Dibrës. Në rastin e Dibrës, në raportin zyrtar vjetor 2018, theksohet se janë nga viti 2017 janë mbartur dy procedime penale; në Raportin e 2017-ës kjo shifër nuk përmendet fare. Inkoherenca të ngjashme shfaqen edhe në rastin e Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Lezhe.
8. Sistemi i regjistrimit të kallzimeve në prokurori është difektoz dhe nuk ofron të dhëna koherente. Kjo vështirëson punën e vlerësimit sistematik të çështjeve penale nga aktorë të pavarur monitorues. Të dhënat mbahen në regjistra të vecuar dhe përpunimi i tyre statistikor ndodh jashët sistemeve të kolauduara apo të standartizuara. Mungesa e një sistemi unik rregjistrimi të çështjeve penale ka pamundësuar vlerësimin e pavarur të punonjës së prokurorisë në drejtim të hetimit që ajo i bën në tërësi krimin dhe në mënyrë të posacme krimin kundër sistemit demokratik të zgjedhjeve.

VI. MBI PUSHIMET NGA PUNA NË KOHË FUSHATE

1. Ministrat teknikë raportuan për rreth 3600 largime apo pushime nga puna në kohë fushate. Një pjesë e madhe e tyre u bënë me motivacionin e përdorimit të paligjshëm të burimeve shtetërore dhe pozicionit të zyrtarit publik për qëllime të fushatës elektorale. Tingëllon paradoksale që një pjesë e konsiderueshme e këtyre largimeve nga puna është bërë me firmë të vetë ministrave teknikë.
2. Në fund të mandatit të tij, ish-prokurori i përgjithshëm Adritik Llala njoftoi hapjen e hetimeve për pushimet nga puna në kohë fushate, të identifikuar në kuadër të Raportit Monitorues të hartuar nga ish-zv kryeministria Teknike, Znj. Ledina Mandija. Nga të dhënat e disponuara nga INFOCIP, nuk rezulton që Prokuroria të këtë hapur një dosje të tillë, bazuar në parashikimet e nenit 328 dhe fraksioneve të tij.
3. Praktika e deritanishme e prokurorisë shqiptare nuk arrin dot të filtrojë nëse pushimet apo largimet nga puna me firmë të funksionarëve të lartë publike janë presion i këtyre të fundit mbi zgjedhësit me synimin për të ndikuar rezultatin e zgjedhjeve (parashikuar nga 328/a i KP të ndryshuar “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”), apo janë veprim legjitim me synim parandalimin e veprës penale që parashikon ky nen. Pavarësisht kualifikimit të figurës së veprës penale nga “kundravajtje penal” në “krim” që ndëshkohet vetëm me burgim, Prokuroria nuk ka një analizë të sajën për të vlerësuar nëse kjo rrethanë rënduese ka frenuar (apo jo) incidencën e “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Ky raport gjithashtu limitohet të realizojë këtë vlerësim, pasi për këtë qëllim do të duheshin të grumbulloheshin me të njëjtën metodologji rastet/incidenca e krimin zgjedhor në zgjedhjet pararendëse parlamentare.

VII. VLERESIME KRITIKE dhe REKOMANDIME

Procesi zgjedhor për Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare të Qershorit 2017 u karakterizua nga akuza për blerje dhe shitje të votave, keq-përdorim të burimeve logjistike shtetërore dhe presione/favore ndaj zgjedhësve lidhur me vendin e punës. Parimi i garantimit të ligjshmërisë nga vetë palët garuese në procesin zgjedhor u reflektua jo vetëm në nivel të administrimit zgjedhor por edhe në nivel qeverisës, me 6 ministra teknikë të caktuar nga opozita të cilët u bënë pjesë e kabinetit qeritar Rama.

Në Zgjedhjet Parlamentare të Qershorit 2017, shqiptarët dhe forcat politike që garuan për vende në Kuvend, hynë me një Kod Penal të ndryshuar, i cili ashpërsoi dënimet për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara këto në Kreun X të tij. Të gjitha kundravajtjet penale u shfuqizuan dhe u rikualifikuan si krime. Me fjalë të tjera, veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në Kreun X të Kodit Penal, pas ndryshimeve ligjore të datës 22/05/2017 janë të ndëshkueshme vetëm me burgim, ndërkohë që praktika e gjobës, e aplikueshme në rastet e konsideruara “kundravajtje penale” nuk ekziston më në RSH.

Pavarësisht këtyre garancive të trefishta, palët ndërvepruese në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, të mbajtura në 25 Qershor 2017, nuk arritën të ndërtonin më shumë besim tek njëra tjetra dhe as tek publiku mbi mbajtjen e zgjedhjeve të lira e të ndershme .

Pjesëmarrja e ulët e votuesve në zgjedhje sugjeroi rënie të mëtejshme të besimit të publikut tek partitë politike që garojnë si subjekte zgjedhore. Mos-ushtimi i të drejtës së votës nga më shumë se gjysma e zgjedhësve është tregues i mungësës së besimit tek sistemi zgjedhor në Republikën e Shqipërisë në përgjithësi. Në vlerësimet e opinionit publik përmes sondazheve, por edhe në studime të tjera që vlerësojnë besueshmërinë në institucionet qeverisëse dhe partitë politike¹⁴, shqiptarët kanë shprehur nivele të ulëta besimi sidomos tek partitë politike dhe tek sistemi gjyqësor, të renditura në fund të listës me rreth 15 institucione të vlerësuara për këtë qëllim.

Ndryshimet në Kodin Penal të RSH, ishin rezultat i marrveshjes së 18 Majit mes PS dhe PD. Ato u bënë të pakonsultuara me të gjithë aktorët vendimarrës dhe ligjzbatues, duke kompromentuar që në fillësë cilësinë e besimit në këto ndryshime të rëndësishme ligjore si dhe paqartësi për zbatimin e tyre rigoroz. Teksa ishte artikuluar nevoja për ndryshime në Kodin Zgjedhor të RSH, palët vendimarrëse PS dhe PD ndërmorën ndryshime në Kodin Penal, për të cilat ishte folur pak ose aspak më parë dhe për të cilat opinion publik, ekspertët apo palë të tjera të interesuara nuk arritën të artikuloreshin para se ato të ktheheshin në një fakt juridik dhe të zinin vend në korpusion e brendshëm legjislativ të RSH.

¹⁴ Të bëra publike për vitin 2016 dhe 2017 nga IDM, mbështetuer nga UNDP dhe BE

Ndryshimet në Kodin Penal u futën në fuqi menjëherë dhe për më tepër disa ditë para zgjedhjeve (dt. 22 maj 2017) duke shënuar një precedent unik sa i takon hyrjes në fuqi legjislative të kodeve në RSH. Koha normale për futjen në fuqi të këtyre akteve juridike është zakonisht 6 muaj, me synim njohjen substanciale nga të gjitha subjektet që ato adresojnë, për efekt të zbatimit të saj rigorozisht pre këtyre të fundit.

As Kuvendi dhe as Qeveria nuk u kujdesën që të kompensojnë urgjencën e prodhuar me fushatë intensive të informimit ligjor të publikut. Kjo konsiderohet një mangësi në administrimin e kujdesshëm të procesit zgjedhor, kuadri ligjor i të cilit ndryshoi në mes të natës, pa konsultime paraprake dhe në prag të fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore.

E vetmja fushatë informuese e regjistruar në periudhën parazgjedhore ka qenë ajo e ndërmarrë nga INFOCIP në rrjetet sociale dhe më pas një fushatë e KQZ e cila zgjati vetëm disa ditë në televizionet me mbulim kombëtar.

Sa i takon ndryshimeve legjislative në Kodin Penal, pavarësisht kualifikimit të figurës së veprës penale që parashikohen në Kreun X nga “kundravajtje penale” në “krim” (që ndëshkohet me burgim), rezultoi se kjo nuk frenoi incidencën e krimit që çënon zgjedhjet. Veprat penale për të cilat janë regjistruar edhe kallzimet më të shpeshta në organin e prokurorisë janë ato që parashikohen nga neni 326 dhe 328 i Kodit Penal, të ndryshuar, respektivisht **“Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve¹⁵”** dhe **“Korrupsioni aktiv në zgjedhje¹⁶”**. Një tjetër parashikim i Kodit penal që rezultoi në shkelur masivisht në zgjedhjet e qershorit 2015 është Neni 328/a **“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”**

Informimi i pamjaftueshëm i zgjedhësve apo i administratës zgjedhore mund të këtë patur një efekt negativ sa i takon mos-parandalimit të kësaj kategorie krimi. Po ashtu, sistemi i përkohshëm bashkëqeverisës midis PS dhe PD që u instaluar gjatë periudhës zgjedhore mund të këtë patur efekt konfundues në këtë drejtim pasi të dyja palët (PS dhe PD) aktivizuan rekrutime apo pushime nga puna njëkohësisht.

Sipas të dhënave të bëra publike nga ministrat teknikë, pretendohet se vetëm prej tyre (pra nga gjysma e kabinetit e kabinetit qeveritar) janë dokumentuar rreth 3600 largime apo pushime nga puna në kohë fushate. Një pjesë e madhe e tyre u bënë me motivacionin e përdorimit të paligjshëm të burimeve shtetërore dhe pozicionit të zyrtarit publik për qëllime të fushatës elektorale. Është paradoksale që një pjesë e konsiderueshme e këtyre largimeve nga puna është bërë me firmën e ministrave teknikë, pjesë e misionit të të cilëve ka qenë edhe garantimi se ndryshimet e bëra në Kodin penal me vullnetin e përbashkët të PS dhe PD në marrvëshjen e 18 Majit 2017 do të respektoheshin.

¹⁵ *Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013*

¹⁶ *Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017*

Praktika e deritanishme e prokurorisë shqiptare nuk arrin dot të filtrojë nëse pushimet apo largimet nga puna me firmë të funksionarëve të lartë publike janë presion i këtyre të fundit mbi zgjedhësit me synimin për të ndikuar rezultatin e zgjedhjeve (parashikuar nga 328/a i KP të ndryshuar “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”), apo janë veprim legjitim me synim parandalimin e veprës penale që parashikon ky nen.

Paragrafi 3 i nenit 328/a¹⁷, përcakton shprehimisht se: *Detyrimi ose kërkesa drejtuar shtetasve, nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, që kundër vullnetit të tyre ose nën kërcënimin e përdorimit të masave administrative ose disiplinore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor, për të marrë ose jo pjesë në zgjedhje, për të mbështetur ose jo një parti politike ose një kandidat në zgjedhje, ose për të votuar në një mënyrë caktuar, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet*”. Në kushtet e bashkeqeverisjes PS–PD në vigjilje të zgjedhjeve Parlamentare të 25 Qershorit 2017, parashikimet e këtij neni janë shkelur masivisht, por në asnjë rast nuk pati më shumë se 20 kallzime në organin e prokurorisë.

Sipas të dhënave të disponuara zyrtarisht nga Prokuria e Përgjithshme, deri në Tetor 2018, nga 4 çështje gjithsej nën hetim, 3 ishin pushuar. Nga vlerësimi i të gjitha evidencave të mbledhura dhe të analizuara për efekt të këtij monitorimi, asnjë prej kallzimeve të regjistruar për vepra penale të parashikuara nga Neni 328/a nuk u dërgua në gjykatë.

Deri në fund të gjatë-mujorit të parë të vitit 2018, që përkon edhe me plotësimin e një viti të plotë kalendarik nga periudha e fundit zgjedhore, organi i prokurorisë arriti të hetonte dhe më pas t’i dërgonte gjykatës vetëm 2 dosje, për çështje të parashikuara nga neni 326¹⁸ i Kodit Penal, të ndryshuar. Ky nen nuk ishte pjesë e ndryshimeve ligjore që u ndërmoren pas marrveshjes së 18 Majit 2017.

Sistemi i regjistrimit të kallzimeve në Prokurori është difektoz dhe nuk ofron të dhëna koherente. Kjo vështirëson punën e vlerësimit sistematik të çështjeve penale nga aktorë të pavarur monitorues. Të dhënat mbahen në regjistra të veçuar dhe përpunimi i tyre statistikor ndodh jashët sistemeve të kolauduara apo të standartizuara. Mungesa e një sistemi unik regjistrimi të çështjeve penale ka pamundësuar vlerësimin e pavarur të punonjës së prokurorisë në drejtim të hetimit që ajo i bën në tërësi krimin dhe në mënyrë të posaçme krimin kundër sistemit demokratik të zgjedhjeve.

Konstohet se të dhënat e mbajtura nga prokuroritë e rretheve nuk përkojnë me të dhënat e përpunuar dhe/ose të shpëndara nga Prokuroria e Përgjithshme në një kohë të dhënë. Kjo mund të ndodh për shkak të periodicitetit mbi bazën e të cilit Prokuroria e Përgjithshme bën rakordimin e të dhënave me prokuroritë e rretheve gjyqësore.

¹⁷ Neni 328/a **Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose Zgjedhore** (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

¹⁸ Neni 326 **Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve** (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimin me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

Po ashtu, ka një mospërputhje thelbësore midis shifrave të rasteve të denoncuara në Policinë e Shtetit (sipas shifrave të bëra publike nga kjo e fundit), dhe rasteve të cilat janë referuar më pas në prokurori. Policia ka rezervuar një marxhinë të konsiderueshme vlerësimi se cilat prej rasteve që përbënin çënim të neneve që përmban Kreu X i Kodit Penal të referonte në prokurori për hetim të mëtejshëm.

Organi i Prokurorisë ka vendosur pezullimin ose pushimin e procesimit penal në një shumicë rastesh. Rezulton se afatet e hetimit janë tejkaluar në shumicën e rasteve të analizuara. Deri në Korrik 2018, pra 1 vit pas përfundimit të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, rezultonin ende nën hetim 42 dosje/raste penale të parashikuara nga kreu X i Kodit Penal, të ndryshuar.

Sipas evidencës të disponuar në rrugë zyrtare, numri me i madh çështjeve ende nën hetim ishte për vepra penale të parashikuar nga neni 326¹⁹, me rreth 20 të tilla. Neni 326 nuk pësoi ndryshime në amendimet e fundit që iu bënë Kodit Penal në 22 Maj 2017. Po ashtu, rezulton se numri i dytë më i madh i dosjeve ende nën hetim deri në fund të Korrikut 2018, rreth 10 të tilla, ka të bëjë me vepra që bien në parashikimet e nenit 328²⁰ të KP. Ky nen ishte subjekt i ndryshimeve që pësoi Kodi Penal i RSH në 22 Maj 2017.

Duke patur parasysh se:

--Shqipëria hyri në zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare të Qershorit 2017 me një kuadër ligjor të ndryshuar sa i takon Ligjit për Mediatⁱ, Ligjit për Partitë Politikeⁱⁱ dhe Kodit Penal të RSH. Ndryshimet për tre këto ligje të rëndësishme u miratuan nga Kuvendi në datë 22 maj 2017 në seancë të jashtëzakonshme.

--Ligji 89/2017, datë 22.05.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995", KP i Republikës së Shqipërisëⁱⁱⁱ, ashpërsoi dënimet për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, por shkalla e hetueshmërisë dhe e ndëshkueshmërisë mbeti më e ulët krahasuar më Zgjedhjet Vendore të vitit 2015;

--Komisioni i Posaçëm Parlamentar i Reformës Zgjedhore që prej vitit 2013 nuk dakortëson dot mbi ndryshimet që duhet të pësojë Kodi Zgjedhor, për të reflektuar në mënyrë adeguate rekomandimet e OSBE/ODHIR, por edhe rekomandimet e rëndësishme të aktorëve vendas që monitorojnë proceset zgjedhore;

--Konstatimet e Raportit Monitorues të INFOCIP për Krimin Zgjedhor adresojnë në thelb çështje që normohen nga Kodi Penal i RSH dhe jo nga Kodi Zgjedhor i RSH, për të cilin ka mandat amendues Komisioni i Posaçëm Parlamentar i Reformës Zgjedhore;

¹⁹ Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

²⁰ Neni 328 **Korrupsioni aktiv në zgjedhje** (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

--Çështjet e aplikimit konkret të qëllimeve të ligjvënës, të materializuara në ndryshimet që pësoi Kodi Penal i RSH në 22 Maj 2017 dhe vlerësimi i pavaruar i zbatimit të normës juridike që ai ka caktuar përbëjnë interes direkt për Kuvendin;

--Zbatimi i ndryshimeve të 22 Majit 2017 në Kodin Penal të RSH gjithashtu përbëjnë një indikator matës të punës së organeve ligjzbatuese, posaçërisht Prokurorisë dhe Policisë;

--Çështjet e integritetit të zgjedhjeve, përfshirë rolin ligjvënës të Kuvendit dhe rolin e institucioneve ligjzbatuese si Prokuroria dhe Policia përbëjnë interes të lartë publik;

INFOCIP ka hartuar një set rekomandimesh, të cilat adresojnë njëkohësisht Kuvendin e RSH, Komisionin e Posaçëm Parlamentar të Reformës Zgjedhore, Prokurorinë e Përgjithshme, Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, aktorët lokale dhe ndërkombëtare që monitorojnë proceset zgjedhore. **Këto rekomandime janë si më poshtë vijon:**

1. Në kuadër të amendimeve të mundshme të Kodit Penal, ligjvënësi të diferencojë në masën e ndëshkimit të parashikuar personin që e blen votën nga personi që e shet votën. Aktualisht Kodi Penal i Ndryshuar kriminalizon njësoj palët ndërvepruese në një veprë penale, sikurse në rastin konkret është parashikuar në nenet 328²¹ dhe 328/b²². Në të dyja figurat e veprës penale, ligjvënësi ka parashikuar dënim nga 1-5 vjet burg për autorët e veprës penale.
2. Penalizimi i zgjedhësit që pranon shpërblimin apo premtimin për një të mirë materiale apo favore të padrejta, zvogëlon mundësinë e vënies përpara drejtësisë të personave që përdorin pushtetin apo postin publik/politik për të blerë vota. Nga ana tjetër, duke patur parasysh diferencat e pranuar që ekzistojnë në statusin shoqëror dhe ekonomik mes dy kategorive respektive, aplikimi i dënimeve të njëjta kompromenton indirekt parimim e barazisë së palëve në procesin penal. Rekomandohet diferencimi mes atyre që ofrojnë para për të fituar në këmbim pushtet politik dhe nga ana tjetër mes atyre që për shkak të kushteve dhe rrethanave specifike të pafavorshme për ta pranojnë të marrin shpërblime (edhe në holla) në këmbim të votes
3. Ligjvënësi të ndërmarrë ndryshime ligjore të cilat sigurojnë një mbrojtje të plotë për këdo që denoncon rastet e krimit zgjedhor, madje edhe për atë që kanë pranuar të shesin votën, të cilët janë viktima të abuzimit me pushtetin nga ata që garojnë në zgjedhje. Vlerësohet se qasja "sinalizuese" do të sillte më shumë informacion për organet hetimore duke ndikuar në një luftë më efektive kundër krimit zgjedhor dhe do të çlironte qytetarët nga barra e bashkëfajësisë.
4. Rekomandohet që, në rastet kur kandidati në zgjedhje apo stefet/mbështetësit e tij, kapen në flagrancë apo faktohet në një kohë më të vonë përmes procedurës së

²¹ Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

²² Korrupsioni pasiv në zgjedhje (Shtuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

hetimit se kanë ofruar para në kohë zgjedhore, para-zgjedhore apo pas-zgjedhore për të blerë votën e zgjedhësve të tij (korrupsion aktiv), çështja e tij ti kalojë për kompetencë lëndore Prokurorisë së Krimeve të Rëndë ose SPAK në kohën kur kjo e fundit të jetë efektive.

5. *Prokuroria, edhe për shkak të ndryshimeve të reja ligjore të ndërmarra në kuadër të Reformës në Drejtësi, nuk duhet të rezervojë të drejtën për të pushuar apo pezulluar hetimin ndaj veprave penale që ka nën hetim. Ky funksion/atribut duhet t'i përkasë gjykatës. Rekomandohet që pushimi i çështjeve penale që përmban në rastin konkret Kreu X i KP, të ndryshuar të bëhet me vendim gjykate.*
6. *Nisur nga rrethana e punësimeve në institucione publike apo agjensi shtetërore dhe kompani sh.a. para fushatës, rekomandohet zgjerimi në kohë i kompetencës lëndore të prokurorisë për të administruar kallzime penale nga subjektet politike/zgjedhore. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, një pjesë e madhe e akuzave politike mes palëve kishin të bënin me përdorimin e funksionit publik për avantazh të padrejtë në zgjedhje si dhe me shitblerje vote të cilat ishin konsumuar përpara filimit zyrtar të fushatës zgjedhore.*
7. *Vendimet e gjykatave që merren për vepra penale mbi parashikimet që përmban Kreu X i Kodit Penal duhet të bëhen publike në një nënkategori të posaçme online dhe të jenë të aksesueshme nga palët e interesuara që vlerësojnë ligjshmërinë e proceseve zgjedhore. Kjo kategori vendimet mund dhe duhet të jetë e disponueshme edhe nga KQZ, në formë diskrete apo dhe përmes një linku në faqen zyrtare.*
8. *Afati i hetimi për çështjet penale nga e prokurorisë si rregull zgjat 3 muaj. Ky konsiderohet edhe si afat procedural standard për kryerjen e një hetimi të plotë para se dosja të shkojë në gjykatë për vlerësim të mëtejshëm të fajësisë. Praktika e vëzhguar nga ky monitoring sugjeron se prokurorët kanë tejkaluar mesatarisht 4 herë këtë afat, duke marrë vendim për të shtyrje. Rekomandohet që zgjatja e hetimit për rastet e parashikuara në Kreun X të KP, të ndryshuar, të bëhet vetëm një herë, me vendim gjykate, ku prokuroria të ofrojë para saj prova për të bindur gjykatën mbi kërkesën për shtyrje. Dimensioni public i procesit gjyqësor për shtyrje hetimi duhet të garantohet për median dhe palët e interesuara.*
9. *Rekomandohet që të perpilohen listat e prokurorëve të cilët kanë specializimin apo trajnim të mjaftueshëm për të hetuar krimin zgjedhor dhe të vlerësohen në tërësi nevojat e prokurorëve të tjerë për trajnime tematike të posaçme, konkretisht në fushën e hetimit të kallzimeve për vepra penale që çënojnë sistemin e zgjedhjeve demokratike.*
10. *Rezultatet e punës hetimore të prokurorëve të shortuar/të caktuar për të hetuar dhe çuar para drejtësisë personat apo subjektet që konsumojnë vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, parashikuar nga Kreu X i KP, të ndryshuar, rekomandohet të behen publike në një raport të posaçëm, të*

hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, i cili i vihet në dispozicion KQZ jo më vonë se një vit nga data e përfundimit të zgjedhjeve më të fundit.

- 11. Raporti Special për hetueshmërinë dhe ndëshkueshmërinë e krimit zgjedhor rekomandohet të përfshihet si një kapitull i posaçëm i analizës vjetore të organit të Prokurorisë që depozitohet më pas në Kuvend zyrtarisht.*
- 12. Sistemi i regjistrimit të kallzimeve në prokurori duhet të rikonceptohet dhe të jetë i aksesueshëm online, për të ndjekur dinamikën e hetueshmërisë së krimit zgjedhor nga subjektet zgjedhore dhe nga cdo person apo organizatë e interesuar. Aktualisht të dhënat mbahen në regjistra të veçuar dhe përpunimi i tyre statistikor ndodh jashtë sistemeve të standartizuara.*
- 13. Krijimi i një sistemi unik regjistrimi të çështjeve penale që çënojnë zgjedhjet në format të unifikuar online (pra jo në file excel-i, sikurse veprohet deri tani nga cdo prokurori rrethesh) do të ndihmonte në vlerësimin e nivelit të incidencës, hetueshmërisë dhe performancës së punonjësve të prokurorisë në drejtim të hetimit që ajo i bëjnë në tërësi krimit dhe në mënyrë të posaçme krimit kundër sistemit demokratik të zgjedhjeve.*
- 14. Së bashku me numrin e procedimeve penale, Prokuroritë e rrethve duhet të marrin masa për të informuar publikun përmes specifikimeve në sistemin e mbajtjes së të dhënave mbi numrin e personave të proceduar penalisht. Shpesh, për të njëjtin procedim penal ka më shumë se një person të kallzuar. Numri i personave të hetuar/të kallzuar duhet të jetë e dhënë publike në format statistikor, të përditësueshëm me bazë mujore.*
- 15. Rekomandohet që Policia e Shtetit të limitohet me ligj ose të vetë-limitohet sa i takon vendimarrjes nga ana e vetë asaj se cili prej denoncimeve duhet referuar në Prokurori dhe cili jo. Të gjitha denoncimet e administruara / depozituar prej saj, apo rastet e konstatuar nga vetë Policia e shtetit në flagrancë apo në rrugë operative, t'i referohen pa përjashtim Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor për veprime të mëtejshme procedurale në rastin e veprave të parashikuara në Kreun X të KP.*
- 16. Rekomandohet që Policia e Shtetit të marrë trajnime të posaçme në këtë drejtim, për të parandaluar abuzimin nga ana e punonjësve të saj me funksionin e rëndësishëm që ajo luan në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, sidomos gjatë ditës së votimit, por edhe në kohë fushate si dhe gjatë numërimit të votave deri në shpalljen e rezultatit.*
- 17. Marrëveshja politike e 18 Majit i hapi rrugë opozitës së kryesuar nga PD të emëronte në poste kyçe, ministra, zëvendëskryeministër dhe drejtues institucionesh. Çaktimi i tyre në pozicione drejtuese u shoqërua me pushime nga puna të stafëve të varësisë. Megjithëse kjo mund të mos përbëjë mirëfilli raste të krimit zgjedhor, motivacioni i pushimit nga puna duhet analizuar posaçërisht. Do të ishte me interes*

të shqyrtohen më nga afër rastet e pushimeve, pezullimeve dhe të procedimeve disiplinore, nesë këto të fundit janë në vetvete shkelje të dispozitave të Kodit Penal sa i takon përdorimit të postit publik për të siguruar avantazh të padrejtë në zgjedhje.

18. *Nisur nga deklaratat e nëpunësve ndaj të cilëve rënduan këto masa, u vu re se vendimet për largim nga puna morën ngjyrimet politike, duke shkuar në drejtim të kundërt të qëllimit të legjislacionit shqiptar dhe parimeve të së drejtës. Për më tepër ato mund të kenë efekte në zbatimin selektiv, arbitrar apo të paqëndrueshëm të legjislacionit shqiptar. Këto veprime, përveç politizimit të administratës, sjellin edhe uljen e besueshmërisë së publikut në institucionet publike por edhe në procesin zgjedhor.*
19. *Drejtoria e Administratës Publike, refuzoi të zbatonte urdhërimet e ministrave teknik, herë duke mos i njohur, herë duke i konsideruar të kundërta-ligjshëm. Kjo konsiderohet një praktikë e mirë në kuadër të këtij Raporti Vlerësues dhe rekomandohet forcimi i saj në të ardhmen.*
20. *Pushime nga puna në kohë fushatë apo edhe marrja në punë e personave në kohë fushate duhet të administrohen nga DAP në një databazë të veçantë me akses publik. Rekomandohet krijimi i një Task Forcë në përbërje të së cilës të jenë përfaqësues të DAP, Inspektorati i Punës (ISHPSHSH), KQZ si dhe dy përfaqësues nga Shoqëria Civile që ka në fokus vlerësimin e veprave penale që lidhen me zgjedhjet apo pushimet nga puna në Administratën Publike.*

VIII. METODOLOGJIA E RAPORTIT

Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOCIP, monitoroi incidencën e veprave penale të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me Krimin Zgjedhor, ndryshuar me ligji nr. 89/2017, datë 22.5.2017, dhe konkretisht të gjitha parashikimet që përmban për këtë lloj krimi, Kreu X i Kodit Penal “*Veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve*”.

Gjithashtu INFOCIP monitoroi edhe punën e organeve shtetërore që ngarkohen me ligj për të hetuar / referuar çdo rast të shkeljes së ligjit penal dhe proceduar shkelësit e neneve që parashikojnë vepra që çënojnë sistemin demokratik të zgjedhjeve në RSH.

Ky monitorim u bazua në mbledhjen e evidencave dhe dokumentimin e plotë të rasteve të raportuara në media, denoncimeve në polici dhe kallëzimeve në prokurori për veprat penale të krimit zgjedhor.

Për të monitoruar situatën e krimit zgjedhor, INFOCIP administroi evidenca në rrugë zyrtare nga disa burime institucionale si Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Task Forca për Monitorimin e Zgjedhjeve Parlamentare të 2017-ës. Për të siguruar një vlefshmëri të gjetjeve është përdorur triangulim i burimeve, duke synuar konfirmimin e gjetjes nga të paktën tre burime të pavarura.

Gjithashtu u morën në shqyrtim raportimet dhe rekomandimet e vëzhguesve vendas dhe të huaj për parandalimin dhe ndjekjen penale të rasteve të krimit zgjedhor, si psh: të presionit ndaj zgjedhësve, të keqpërdorimit të burimeve shtetërore për qëllime të fushatës, të blerjes së votës, të fshehtësisë së votës dhe integritetit të procesit.

Për klasifikimin e krimit zgjedhor, është marrë parasysh klasifikimi që ka bërë Kuvendi, i cili në relacionin shpjegues për ndryshimet në KP¹ ka afirmuar si qëllim kryesor rritjen e përgjegjshmërisë së të gjithë aktorëve të angazhuar në zgjedhje, dhe në veçanti:

- *Garantimin e një procesi të rregullit ligjor bazuar në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor;*
- *Garantimin e fshehtësisë së votës;*
- *Ndalimin e shitblerjes së votës;*
- *Garantimi për mospërfshirje në fushatë të nxënësve të arsimit parauniversitar;*
- *Garantimi i mospërdorimit të të mirave publike apo të burimeve financiare shtetërore nga funksionare të administratës shtetërore;*
- *Garantimi për mosdetyrimin e punonjësve të administratës për të marrë pjesë në fushatën zgjedhore;*
- *Garantimi i administrimit të rregullt të procesit zgjedhor nga anëtarët e komisioneve zgjedhore*
- *Garantimin e mosshpërdorimit të autoritetit policor apo ushtarak në procesin zgjedhor.*

Këto qëllime të ligjvënësit janë përdorur nga INFOÇIP si platformë monitorimi për vlerësimin koherent të situatës së krimit zgjedhor, duke mbledhur evidenca të rasteve që bien ndesh me këto qëllime.

Të dhënat dhe faktet që sinjalizojnë shkelje të parashikimeve ligjore që përmban Kreu X i KP në kohë fushatë, ditën e votimit dhe gjatë numërimit të votave dhe shpalljes së rezultateve janë bërë publike nga INFOÇIP në datë 24 Qershor 2017²³.

Evidenca përmbyllëse për vitin 2017-2018 është disponuar në rrugë zyrtare nga organi i Prokurorisë në 4 faza: Faza e parë përkon më mbylljen e tre-mujorit të parë pas përfundimit të periudhës së fushatës zgjedhore. INFOÇIP disponoi me shkrim përgjigje zyrtare nga Prokuroria e Përgjithshme në datë 25/10/2017, firmosur nga sekretari i Përgjithshme në atë kohë, Z. Genti Kosumi.

Evidenca e dytë është disponuar po në rrugë zyrtare nga Prokuroria e Përgjithshme, dhe ajo mbulon plotësisht 6 mujorin e dytë të vitit 2017. Një evidencë e tretë është disponuar nga Prokuroria e përgjithshme dhe ajo e rrethit Gjyqësor Tiranë, në datë 15 Prill 2018. Ajo pasqyron situatën faktike të procedimeve penale për kreun X të Kodit Penal dhe pritet të konsolidohet zyrtarisht në fund të muajit Prill 2018.

INFOÇIP ka vijuar të mbledhë në mënyrë sistematike të dhëna zyrtare nga Prokuroria e Përgjithshme për të paktën tre raunde të njëpasnjëshme deri në fund të vitit 2018. Evidenca përfundimtare është administruar në Prill 2019. Synimi i mbledhjes konstante të informacionit zyrtar është bërë për të vlerësuar koherencën e referimit të çështjeve të reja

²³ <http://www.infocip.org/al/?p=12302>

hapura apo edhe të çështjeve të cilat janë pushuar me vendim nga ana e prokurorisë. Shkaqet e mbylljes së hetimeve janë administruar gjithashtu, por ato dalin jashtë objektivit të Raportit.

Po ashtu, INFOCIP ka disponuar përmes burimeve të veta, informacion alternativ lidhur me situatën e personave të proceduar, sikurse ajo rezulton në regjistrat e organit të Prokurorisë, për procedime që regjistrohen në kategorinë “Vepra Penale për Zgjedhjet e lira”.

Burim parësor i mbledhjes së të dhënave kanë qënë fillimisht subjektet zgjedhore në kohë fushatë të cilat kanë referuar në organet e medias shqetësimet e tyre, përfshi denoncimet në Polici dhe kallzimet në Prokurori. Organet e medias kanë pasqyruar rigorozisht një numër shumë të lartë denoncimesh të bëra në kohë fushatë nga vetë aktorët institucionalë dhe subjektet zgjedhore.

Një grup i posaçëm monitoruesish të INFOCIP kanë rakorduar të gjitha të dhënat e bëra publike nga vetë subjektet zgjedhore duke marrë kontakt të drejtpërdrejtë me personat e ngarkuar për këtë qëllim duke konfirmuar vërtetësinë e të dhënave të bëra publike.

Burime të tjera të rakordimit të të dhënëve kanë qënë edhe Raportet periodike si dhe Raporti Final i Ministrave Teknike, por edhe monitorimet e aktorëve të shoqërisë civile shqiptare të procesit të votimit. Raportet ndërkombëtare nuk janë marrë parasysh në këtë vlerësim, pasi ato, për vetë natyrën e tyre, nuk e ushtrojnë dot funksionin monitorues përtej mandatit të periudhës zgjedhore.

IX. BAZA LIGJORE DHE LEGJITIMITETI

Shqipëria hyri në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të Qershorit 2017 me një kuadër ligjor të ndryshuar si rezultat i marrëveshjes së arritur mes dy forcave kryesore politike në vend, Partisë Socialiste (PS) dhe Partisë Demokratike (PD). Ligji për Mediat², Ligji për Partitë Politike³ dhe Kodi Penal (KP) ndryshuan duke krijuar një mjedis të ri ku u zhvillua procesi zgjedhor. Këto ndryshime ligjore të rëndësishme u miratuan nga Kuvendi në datë 22 maj 2017 në seancë të jashtëzakonshme dhe hynë në fuqi menjëherë.

Ligji 89/2017, datë 22.05.2017 *”Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995”*, KP i Republikës së Shqipërisë⁴, parashikon riklasifikim të veprave penale që lidhen me zgjedhjet si dhe ashpërsim të politikës penale, duke i klasifikuar ato për herë të parë si krime dhe jo më kundërvajtje penale. Pas ndryshimeve që pësoi Kodi Penal, nuk ka më sanksione me gjobë, por vetëm dënime me burgim, nga disa muaj deri 5 apo dhe 7 vjet.

Ndryshimet që u bënë në Kreun X të KP ishin të menjëhershme dhe madje vetë ligji amendues ka hyrë në fuqi menjëherë. Kjo është një praktikë parlamentare jo-e zakonshme (për hyrjen në fuqi të ligjeve të zakonshme parashikohet një kohë prej 15 ditë pas botimit në fletore zyrtare, kurse për Kodet parashikohet si rregull një kohë deri në 6 muaj nga hyrja në fuqi e ndryshimeve). Për më tepër këto ndryshime të rëndësishme në Kod nuk u paraprinë nga konsultime me publikun. Ato ishin rrjedhojë direkte e paktit mes dy forcave kryesore parlamentare, PS dhe PD. Këto ndryshime, pasi u adoptuan me ligj, nuk u pas-shoqëruan me ndonjë fushatë të mirëfilltë informimi ligjor që publiku t’i kuptonte efektivisht.

X. TASK FORCA PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Me qëllim implementimin e ndryshimeve të reja ligjore, Këshilli i Ministrave miratoi në datë 1 Qershor 2017 Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 473, “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”.⁵ Ky akt nënligjor qëndroi në fuqi deri në 25 qershor 2017 dhe në pikën 23 të saj, urdhëronte krijimin e një *Task-Force* që drejtohet nga Zv. Kryeministri dhe kishte në përbërje shtatë ministra, sekretarin e përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në mbledhjet e Task-Forcës u ftuan të merrnin pjesë edhe:

1. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
2. Avokati i Popullit
3. Një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme;
4. Një përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ);

Task-Forca, në bashkëpunim me titullarët e ministrave dhe grupet e monitorimit, duhet të përmbushte një sërë detyrash që lidheshin ekskluzivisht me garantimin e një procesi zgjedhor të rregullt dhe të pacënuar nga veprat penale të krimit zgjedhor. Një shpjegim i detajuar i përbërjes dhe kompetencave të kësaj Task Force e gjeni në Shtojcën 1 të këtij raporti.

Me gjithë qëllimin e mirë, Task Forca pati probleme të mëdha koordinimi, çka vështirësoi punën e saj monitoruese⁶. Vlen të veçohet që ndër detyrat e ngarkuara për Task Forcën, ishte:

(ë) Njoftimin apo kryerjen e kallëzimit penal në Prokurorinë e Përgjithshme për raste të marrjes/vënies në dijeni për kryerjen e veprave penale në fushën zgjedhore. Në ushtrimin e një kompetence të tillë, Task Force aktivizonte detyrimisht dispozitat e KP, të ndryshuara me ligjin nr. 89/2017, datë 22.05.2017.

Megjithëse nuk ishte fokus i këtij studimi, do të ishte me interes të shqyrtohen më nga afër rastet e pushimeve, pezullimeve dhe të procedimeve disiplinore, ku në disa raste u vu re një mungesë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve. Drejtoria e Administratës Publike, refuzoi të zbatonte urdhërimet e ministrave teknik, herë duke mos i njohur, herë duke i konsideruar të kundër-ligjshëm.

INFOCIP, i trajtoi në mënyrë të individualizuar të gjitha rastet dhe në përfundim vlerëson se veprime të tilla duhet të konsiderohen në kundërshtim të parimeve të shtetit të së drejtës, demokracisë dhe pavarësisë së institucioneve. Nisur nga deklaratat e nëpunësve ndaj të cilëve rënduan këto masa, vihet re se këto vendime, kryesisht, morën ngjyrimet politike, duke shkuar kështu, në drejtim të kundërt të qëllimit të legjislacionit shqiptar dhe parimeve të së drejtës. Për më tepër ato mund të kenë efekte në zbatimin selektiv, arbitrar apo të paqëndrueshëm të legjislacionit shqiptar. Këto veprime, përveç politizimit të administratës, sjellin edhe uljen e besueshmërisë së publikut në institucionet publike por edhe në procesin zgjedhor.

I. SHTOJCAT

Shtojca 1 – Informacion për VKM mbi Task Forcën për krimin zgjedhor

Me qëllim implementimin e ndryshimeve të reja ligjore, Këshilli i Ministrave miratoi në datë 1 Qershor 2017 Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM)nr. 473, “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”.⁷

Ky akt nënligjor qëndroi në fuqi deri në 25 qershor 2017 dhe synonte:

“marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017, me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve e partive politike në marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe burimet e saj, për krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike në procesin elektorale, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake.”

Për koordinimin e procesit të monitorimit, VKM në fjalë, në pikën 23 të saj, urdhëronte krijimin e një *Task – Force* që drejtohet nga Zëvendëskryeministri dhe kishte në përbërje:

1. Ministrin e Punëve të Brendshme;
2. Ministrin e Mbrojtjes;
3. Ministrin e Financave;
4. Ministrin e Arsimit dhe Sportit;
5. Ministrin e Drejtësisë;
6. Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
7. Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore;
8. Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave;
9. Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike;
10. Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
11. Drejtorin e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave.

Në mbledhjet e Task-Forcës ftoheshin të merrnin pjesë:

5. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
6. Avokati i Popullit
7. Një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme;
8. Një përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ);

Task-Forca, në bashkëpunim me titullarët e ministrive dhe grupet e monitorimit, duhet të përmbushte detyrat e mëposhtme:

- a. Monitorimin e sjelljes dhe veprimtarisë së administratës shtetërore sipas këtij vendimi;
- b. Monitorimin e administratës shtetërore në drejtim të përdorimit të autoritetit shtetëror vetëm në përputhje me ligjin duke mos lejuar përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të shtetit gjatë procesit zgjedhor si dhe duke mos lejuar kryerjen e veprimeve dhe/ose dhënien e premtimeve, favoreve apo moscenimin e të drejtave të shtetasve, si mekanizëm për favorizimin apo dhënien e votës një subjekti politik;

- c. Monitorimin e procesit zgjedhor me qëllim konstatimin dhe raportimin e përdorimit gjatë fushatës dhe procesit zgjedhor të mjeteve financiare nga burime të paligjshme apo të krijuara nga veprimtari të paligjshme;
- d. Monitorimin e procesit zgjedhor, përfshirë ditën e votimit, në funksion të mospërfshirjes në të të zyrtarëve apo personave të tjerë që ndodhen në institucione shtetërore, përfshirë personat e burgosur, dhe marrjen e masave për ndëshkimin e atyre zyrtarëve që veprojnë në kundërshtim me ligjin. Pjesë e kësaj detyre është edhe monitorimi i lëvizjes së nëpunësve të lartë dhe të mesëm shtetërorë në qendër dhe qarqe apo bashki gjatë procesit zgjedhor;
- e. Monitorimin e përditësimit dhe ndjekjen e problematikave me listat e zgjedhësve;
- f. Monitorimin e zbatimit të masave për pezullimin e iniciativave për kontrata të përkohshme në nivel qendror e vendor;
- g. Monitorimin e përditësimit të akteve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
- h. Njoftimin apo kryerjen e kallëzimit penal në Prokurorinë e Përgjithshme për raste të marrjes/vënies në dijeni për kryerjen e veprave penale në fushën zgjedhore;
- i. Njoftimin e Avokatit të Popullit kur merr apo vihet në dijeni për kryerjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë procesit zgjedhor;
- j. Njoftimin e KQZ kur merr dijeni apo vihet në dijeni për problematika të procesit zgjedhor;
- k. Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me Policinë e Shtetit në funksion të marrjes së masave të menjëhershme në përputhje me ligjin kur konstatohen raste të sjelljeve apo veprimtarive të kundërligjshme gjatë procesit zgjedhor;
- l. Çdo detyrë tjetër në funksion të monitorimit të zbatimit të këtij vendimi.

Ndër detyrat e ngarkuara, sikurse evidentohet edhe më sipër është:

(ë) Njoftimin apo kryerjen e kallëzimit penal në Prokurorinë e Përgjithshme për raste të marrjes/vënies në dijeni për kryerjen e veprave penale në fushën zgjedhore. Në ushtrimin e një kompetence të tillë, Task Force aktivizonte detyrimisht dispozitat e KP, të ndryshuat me ligjin nr. 89/2017, datë 22.05.2017.

VKMnr. 473 / 2017, shfuqizoi Urdhrin e Kryeministrit nr.65, datë 12.05.2017

“Për marrjen e masave për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme, pronë e administratës publike, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike, të çdo niveli, për zgjedhjen e Kuvendit, të datës 18 qershor 2017.

Shtojca 2

Informacion i detajuar për shkarkimet, pezullimet nga puna, procedimet disiplinore dhe kallëzimet penale të depozituara në rend kronologjik sipas raportimit në Media

Më poshtë janë renditur të gjitha rastet e shkarkimeve, pezullimeve nga detyra, masave të tjera disiplinore dhe kallëzimeve penale, të renditura në radhë kronologjike, si më poshtë:

1. **01/06/2017 - Ministria teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina**, konstatoi përfshirjen e disa drejtuesve e punonjësve arsimorë në fushatën elektorale, duke ushtruar presion në forma të ndryshme tek nxënësit dhe mësuesit, dhe konkretisht personat e poshtë shënuar:
 - a. Përgjegjëse e Zyrës Arsimore, Kurbin, znj. Majlinda Shalsi Cara
 - b. Përgjegjës i Zyrës Arsimore, Gramsh, z. Xhevit Dermyshe
 - c. Përgjegjës i Zyrës Arsimore, Has, z. Selman Qema
 - d. Mësuese në gjimnazin “Ibrahim Rrugova” Tiranë, znj. Arjana Metaliaj
 - e. Mësues në gjimnazin “AsimVokshi”, në Bajram Curri, z. Afrim Brahaj
 - f. Përgjegjëse e Zyrës Arsimore, Bulqizë, znj. Bedrie Manjani
 - g. Drejtor i DAR Lezhë, z. Bardhok Pula
 - h. Përgjegjës i Zyrës Arsimore Librazhd, znj. Fatbardha Qatja.
 - i. Drejtor i shkollës “Mihal Davidhi” në fshatin Gorre, Lushnje, z. Gent Andrea.
 - j. Drejtor i shkollës 9-vjeçare në fshatin Çermë e Sipërme, Lushnje, z. Agim Maci.
 - k. Drejtor i DAR Gjirokastrë, znj. Lindita Rova.
2. **01/06/2017 - Ministri teknik i Brendshëm, z. Dritan Demiraj**, shkarkoi nga detyra drejtorin e policisë në Vaun e Dejës, që kërcënoi reporterin e PD dhe shoferin e tij. Nuk ka të dhëna mbi identitetin e autorit.
3. **02/06/2017 - Ministria teknike e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, znj. Xhuljeta Kërtusha**, shkarkoi me motivacionin se mori pjesë në fushatën e PS, Drejtoreshën e Zyrës së Punës në Tiranë, Marisa Kaçori. Nga ana tjetër, Marisa Kaçori i kërkoi që të faktojë me prova se kur ka qenë në fushatën e PS-së. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
 - b. Marisa Kaçori ka kërkuar nga ministria teknike e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Xhuljeta Kërtusha që të faktojë kur ka qenë në fushatën e PS-së. Ajo shprehet se nuk mori asnjë shkresë zyrtare në lidhje me propozimin e ministres për shkarkim nga puna. Nga kontakti që pati edhe me Drejtorin e Përgjithshëm, as ai nuk ka marrë asnjë shkresë zyrtare. Lajmërimin për shkarkim nga puna e ka mësuar nga media. Ajo i kërkoi ministres teknike të faktonte me foto bashkë me orarin përkatës në të cilin ato janë shkrepur. Kjo pasi në bazë të urdhrin të kryeministrit, punonjësit e administratës publike mund të merrnin pjesë në fushatë pas orarit zyrtar të punës.
4. **03/06/2017 – Shtetasja Haris Ngjegari**, që mbante funksionin e Drejtoreshës së filialit të Postës Berat, akuzohet se ka shkelur ligjin duke bërë fushatë për LSI-në në zyrat e postës. Ajo reagoi duke mohuar akuzat.
5. **03/06/2016 - Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi**, shkarkoi:

- a. Drejtorin e IEVP Fier, z. Jetnor Krakulli, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim e ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Jetnor Krakulli. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- b. Regjistruesin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, z. Ani Dyrmishi, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Ani Dyrmishi. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- c. Drejtorin e IEVP Lezhë, z. Eduart Kurti. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- d. Regjistruesin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, znj. Adriana Shehu, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetases Adriana Shehu. Gjithashtu, sipas medias ndaj kësaj shtetaseje është kërkuar nga gjykata marrja e masës së sigurimit personal “arrest me burg”.Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- e. Drejtorin e IEVP Rrogozhinë, z. Ahmet Bala. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- f. Drejtorin e IEVP Burrel, z. Fatjon Kurti, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Fatjon Kurti. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- g. Kryetarin e Zyrës së Përmbartimit Gjyqësor Durrës, z. Surin Hoxha, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Surin Hoxha. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- h. Drejtorin e IEVP “Jordan Misja” (Nr.313), z. Fatjon Fana. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- i. Drejtorin e IEVP në Tropojë, z. Granit Kurmekaj, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e

kallëzimit penal ndaj shtetasit Granit Kurmekaj. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

- j. Regjistruesin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, z. Edmond Ndou. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- k. Regjistruesin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, z. Ledian Shehu për përdorim të funksionit publik për veprimtari zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Ledian Shehu. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- 6. **03/06/2017 – Shtetësja Sajmira Laci**, që mbante funksionin e Drejtoreshës së Shëndetit Publik në Pukë, u pezullua për shkak se u angazhua në fushatë elektorale. Ajo ishte gjithashtu kryetare e LSI Pukë dhe kandidatë për deputete me po atë forcë politike.
- 7. **05/06/2017 - Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi**, shkarkoi kreun e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Policisë së Burgjeve, shtetasin Ramazan Topuzi, me motivacioni se emërimi në këtë detyrë ishte bërë në kundërshtim me ligjin. Shtetasi Ramazan Topuzi rezultoi i shkarkuar dy herë nga policia e shtetit, për shkelje të rëndë të detyrës, si cënim të figurës së punonjësit të policisë dhe për mosparaqitje në detyrë e mangësi të theksuara në kryerjen e detyrës. Veç këtyre dy rasteve të evidentuara edhe në shkresën zyrtare të policisë së shtetit, burimet nga prokuroria thonë se Topuzi në kohën që ushtronte profesionin e avokatit, pas vitit 2009 është kallëzuar dy herë, për akuzën e mashtrimit dhe atë të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj prokurorit dhe gjyqtarëve.
- 8. **05/06/2017 - Ministria e Ekonomisë, znj. Milva Ekonomi**, shkarkoi nga puna Drejtorin e Postës Majlind Lazimi. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

Ky i fundit, thotë se lirimi i tij nga detyra është akt i pastër politik, i paligjshëm, vetëm për arsye politike dhe nuk ka asnjë bazë ligjore. Në një prononcim për mediat ai ka theksuar se nuk është bërë presion ndaj asnjë punonjësi të Postës Shqiptare. Ish-drejtori i Postës Shqiptare Majlind Lazimi bëri kallëzim penal në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj ministres së Ekonomisë Milva Ekonomi për shkarkimin nga detyra, për shpërdorim detyre, në bazë të Nenit 248 të Kodit Penal, ndërsa paralelisht dërgoi një padi edhe në Gjykatën Administrative.

- 9. **06/06/2017 – Ministri teknik i Shëndetësisë, z. Arben Beqiri**, shkarkoi nga detyra e Drejtorit të Spitalit Rajonal Berat, Ildir Farshërin, gjatë një takimi me dyer të mbyllura me shefat e pavionëve. Në vend të tij u emëruar Asqiri Vasili.

06/06/2017 – Burime nga policia Berat bënë me dije se shtetasi Ildir Farshëri po hetohet pas dyshimeve për blerje votash për llogari të një subjekti politike. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

10. 06/06/2017 - Ministria teknike e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, znj. Xhulieta Kërtusha, firmosi propozimin për largim nga puna të Gent Halilaj me detyrë, Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Kukës, me motivacionin se kishte fakte që vërtetnin pjesëmarrjen në aktivitete të fushatës gjatë orarit zyrtar të punës.
11. 06/06/2017 – Ministri teknik i Shëndetësisë, z. Arben Beqiri, referoi në Prokurori dhe mori masë për pezullimit nga detyra për shtetasin Bledar Hima, Drejtor i shërbimit spitalor Librazhd, bazuar në informacionet dhe ankesat e bëra për pjesëmarrje aktive në fushatë zgjedhore gjatë orarit zyrtar. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
12. 06/06/2017 - Ministria teknike e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, znj. Xhulieta Kërtusha, propozoi largimin nga puna të shtetases Luiza Qipo, me detyrë Përgjegjëse e Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore Ersekë, me arsyetimin se mori pjesë në fushatën elektorale të Partisë Socialiste gjatë orarit zyrtar të punës. Ky propozim i është drejtuar z. Astrit Hados, Drejtor i Institutit të Sigurimeve Shoqërore,
13. Z. Ilirjan Muho u liruar nga detyra në postin e drejtorit të Hipotekave, duke u zëvendësuar nga Arjan Bylykbashin. Ky largim erdhi pas marrëveshjes së 18 Majit ndërmjet liderëve të PS, njëkohësisht kryeministër i vendit, z. Edi Rama dhe liderit të PD, z. Lulzim Basha.
14. Z. Miklovan Kopani u liruar nga detyra në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, duke u zëvendësuar nga Arjan Hoxha. Ky largim erdhi pas marrëveshjes së 18 Majit ndërmjet liderëve të PS, njëkohësisht kryeministër i vendit, z. Edi Rama dhe liderit të PD, z. Lulzim Basha.
15. 07/06/2017 – Ministria teknike e Financave, znj. Helga Vukaj, kallëzoi në prokurori drejtorin e Tatimeve të Kukësit, shtetasin Albert Halilaj, me motivacionin e përfshirjes në fushatën zgjedhore. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

07/06/2017- Ministria teknike e Financave, znj. Helga Vukaj, kallëzoi një doganierë të degës Tiranë, shtetasin Adriatik Hamza, me motivacionin e përfshirjes në fushatën zgjedhore. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) (1)

07/06/2017- Ministria teknike e Financave, znj. Helga Vukaj, kallëzoi një doganierë të degës Kakavijë, shtetasin Misto Kano, me motivacionin e përfshirjes në fushatën zgjedhore. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) (1)

16. 08/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, pushoi nga puna shtetasin Neritan Çela, specialist në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive, me akuzën se ishte përfshirë në fushatën zgjedhore gjatë orarit zyrtar. Urdhri mban firmën e kryeregjistruesit Arjan Bylykbashi. Në të njëjtën kohë, shtetasi Neritan Çela rezultoi të jetë edhe bashkëshort i deputetes së LSI-së, Silva Caka.

08/06/2017 - Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, pezulloi nga detyra shtetasen Juliana Hoxha, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, e cila garonte për një mandat deputeti në Qarkun Tiranë nën siglën e PS-së. Sipas ministrit teknik, Sekretari i Përgjithshëm është figura më e lartë e administratës publike në ministri apo institucionet e tjera shtetërore dhe aktiviteti politik ishte i papajtueshëm me këtë funksion.

Ndërkohë që Departamenti i Administratës Publike ka rikthyer shtetasen Juliana Hoxha në detyrë dhe nuk e ka pranuar kërkesën për pezullim të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë duke e vlerësuar atë si të pabazuar. DAP ka vendosur përfundimin e procedurës për pezullim dhe vendimi hynte në fuqi menjëherë. Ndër të tjera thoshte se nuk mund të vendoste pezullimin e një nëpunësi civil të kategorisë së lartë drejtuese, pa respektuar të drejtat e tij procedurale dhe dëgjuar atë. Por Ministria e Drejtësisë deklaroi se nuk e njihte vendimin e DAP, për kthimin në detyrë të sekretares së shkarkuar të këtij dikasteri.

17. 09/06/2017 – Ministria teknike e Mirëqënies Sociale, znj. Xhuljeta Kërtusha, firmosi largimin nga puna të shtetasit Ervis Xhelo, me funksion Drejtor Rajonal i Sigurimeve Shoqërore Elbasan, i cili mbështeste subjektin politik PDIU, me akuzën se ishte përfshirë në fushatën zgjedhore gjatë orarit zyrtar.

18. 09/06/2017 – Seksioni i Hetimit të Korrupsionit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë kallëzoi në prokurori administratorin e NJA 2 në Tiranë, shtetasin Elez Gjoza, me pretendimin se regjistroi 70 persona në mënyrë fiktive sikur ishin pjesë e banesës së tij. Burime policore njoftuan se materiale procedurale janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Baza ligjore e referuar: Neni 331 Shkelja e së drejtës së zgjedhjes (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

19. 09/06/2017 - Ministria teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina, kërkoi pezullimin nga puna të Drejtoreshës së Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë, Albana Hodaj sepse kundërshtoi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 473, datë 01.06.2017.²⁴ Ndërkohë, Plarent Ndreca, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve theksoi se nuk ka nisur asnjë procedurë pezullimi apo shkarkim. Ai shtoi se administrata publike mbrohet nga ligji

²⁴ Raporti i Ministrit të Arsimit dhe Sporteve, (ANEKSI II), faqe 5.

për nëpunësin civil të miratuar me konsensus të gjerë politik. Pezullimi dhe largimi i nëpunësve civil bëhet bazuar në procedurat e parashikuara me ligj.

20. **10/06/2017 - Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi**, kallëzoi në prokurori kandidatin për deputet të Qarkut Berat, shtetasin Fadil Nasufi, me akuzën se shfrytëzoi veprimtarinë e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, për qëllime të përfitimit politik në zgjedhje. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

10/06/2017 - Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, kallëzoi në prokurori shtetasin Ledian Shehu, me funksion Regjistruer i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, me akuzën se shfrytëzoi veprimtarinë e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, për qëllime të përfitimit politik në zgjedhje. Baza ligjore e mundshme: Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

21. **12/06/2017 - Ministria teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina**, depozitoi në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kallëzimin penal për shtetasin Plarent Ndreca, me funksion Sekretar i Përgjithshëm i kësaj ministrie, me akuzën se konsumoi shkelje ligjore të kryera jashtë kompetencave të funksionit të tij, që cënonin veprimtarinë e institucionit gjatë procesit të Maturës Shtetërore 2017,⁸ shpërdorim detyre, në bazë të Nenit 248 të Kodit Penal.

13/06/2017 - Ministria teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina, urdhëroi pezullimin e menjëhershëm nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, shtetasit Plarent Ndreca, me urdhrin e Ministrit Nr.7/Extra, për shkak të mospërbushjes së detyrave funksionale që solli pasoja shumë të rënda në mbarëvajtjen e punës së institucionit.

13/06/2017 - Ministria teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina, urdhëroi pezullimin e menjëhershëm nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse, z. Alqi Kushi, me urdhrin Nr. 355, për shkak të mospërbushjes së detyrave funksionale që solli pasoja shumë të rënda në mbarëvajtjen e punës së institucionit.⁹

13/06/2017 - Ministria teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina, urdhëroi pezullimin e menjëhershëm nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit, znj. Ornela Koleka, me urdhrin Nr. 342, për shkak të mospërbushjes së detyrave funksionale që solli pasoja shumë të rënda në mbarëvajtjen e punës së institucionit.

22. **13/06/2017 – Administratori i OSHEE-së, z. Haki Mustafa** urdhëroi pezullimin e drejtorit të operatorit për rajonin e Elbasanit, z. Bukurosh Maçi, me motivacionin se kishte marrë pjesë në fushatë zgjedhore gjatë orarit zyrtar. Ai u zëvendësua menjëherë nga drejtuesi i komanduar, z. Alfred Mitro. Baza ligjore e pushimit: Neni 153 pika 1,2, neni 154 pika 1 i Kodit të Punës si dhe VKM nr. 473 datë 01/06/2017 pika 2 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017.

13/06/2017 – Administratori i OSHEE-së, z. Haki Mustafa urdhëroi pezullimin e shefit të agjencisë së OSHEE Pukë, z. Ndue Nikolli, i cili u zëvendësuan menjëherë nga z. Admir Uruçi. Baza ligjore e pushimit: Neni 153 pika 1,2, neni 154 pika 1 i Kodit të Punës si dhe VKM nr. 473 datë 01/06/2017 pika 2 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017.

23. **13/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi**, shkarkoi nga detyra drejtorin e burgut të Vlorës, shtetasin Bashkim Habilaj, me motivacion braktisje e detyrës dhe keq-menaxhim i institucionit. Zyrtarisht, Ministria e Drejtësisë thotë se drejtori i burgut Vlorë, “pa asnjë arsye të përligjur dhe pa asnjë njoftim, nuk paraqitet në detyrë prej disa ditësh. Kjo sjellje përbën braktisje të detyrës dhe është administrativisht dhe penalisht e dënueshme”. Baza ligjore e referuar: Neni 248 Shpërdorimi i detyrës (Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

13/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, shkarkoi nga detyra drejtorin e burgut të Fushë Krujës, shtetasin Albert Malaj, me motivacion braktisje e detyrës dhe keq-menaxhim i institucionit. Zyrtarisht, Ministria e Drejtësisë thotë se “nuk ka menaxhuar në mënyrë efektive stafin nën varësinë e tij, ku janë vërejtur mungesa të pajustificuara; ka lejuar, nëpërmjet mosveprimit, futjen e sendeve të ndaluara në institucion, ku përfshihen jo vetëm telefona celular, por edhe pije të ndryshe alkoolike; ka lejuar, nëpërmjet mosveprimit, shkeljen e rregullave mbi oraret e regjimit të brendshëm, duke shkaktuar kaos në institucion, si dhe duke rrezikuar sigurinë; ka shkelur rregullat mbi kontraktimin e operatorëve tregtar që veprojnë brenda IEVP; si dhe ka shkelur rregullat e takimeve të lejuara midis të burgosurve dhe familjarëve të tyre, si dhe rregullat e akomodimit të të dënuarve”. Baza ligjore e referuar: Neni 248 Shpërdorimi i detyrës (Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

24. **17/06/2017 – Policia e Beratit** ndaloi shtetasit M.T., 55 vjeç, G.T. 45 vjeç, G.M 48 vjeç, të tre banues në Berat, mbi informacionet se kanosën me armë zjarri kryetarin e LSI-së, z. Krenar Shehu, me qëllim pengimin e angazhimit në fushatën elektorale të subjekti politik LSI. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat. Baza ligjore e referuar: Neni 329 “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”

dhe Neni 325 Pengimi i subjekteve zgjedhore (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

25. **17/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi**, urdhëroi kallëzimin në Prokurori të shtetasit Ardit Hotaj, me funksion politik, Koordinator i LSI në Malësinë e Madhe, me akuzën se krijoi perceptimin tek qytetarët se do i punësonte në IEVP Shkodër, që pritej të hapej në muajt në vijim. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

17/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, i kërkoi Prokurorisë të verifikonte rolin e kandidatit për deputet për Qarkun Shkodër, Agron Çela, pasi ekzistonin informacione se krijoi perceptimin tek qytetarët se do i punësonte në IEVP Shkodër, që pritej të hapej në muajt në vijim. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

17/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi i kërkoi Prokurorisë të verifikonte rolin e kandidatit për deputet për Qarkun Shkodër, Dritan Ylli, pasi ekzistonin informacione se krijoi perceptimin tek qytetarët se do i punësonte në IEVP Shkodër, që pritej të hapej në muajt në vijim. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

26. **17/06/2017 – Seksioni Kundër Krimin Ekonomiko-Financiarë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër**, shpalli në kërkim shtetasin Pjetër Prendi 42 vjeç, banues në Shkodër. Ai dyshohej se u premtoi me iniciativën e tij disa shtetasve nga 10.000 lekë për çdo votë që do të jepnin për një kandidat për deputet në Qarkun Shkodër. Materialet procedurale u referuan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

27. **18/06/2017 – Ministria teknike e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, znj. Xhulieta Kërtusha**, kallëzoi në Prokurori shtetasin Saimir Plaku, pasi edhe pse ishte i shkarkua nga detyra e Drejtorit të Zyrës së Punës Kuçovës, vijonte të përdorte zyrat shtetërore në funksion të fushatës.

28. **20/06/2017 - Subjekti politik LSI** kallëzoi në prokurori kryetarin e PS-së, njëkohësisht kryeministër i vendit, shtetasin Edi Rama, me akuzën se gjatë mitingut elektoral të datës 16/06/2017 në Berat, i bënte thirrje të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, që në momentin që linin uniformën, pas punës, të përkushtoheshin për të marrë sa më shumë vota për PS-në, në mënyrë që të mos lejonin rikthimin e hijes së turpmit mbi uniformën e tyre. Para depozitimit të kallëzimit penal, Ministri teknik i Brendshëm, z. Dritan Demiraj, e cilësoi si antiligjore thirrjen e kryeministrit dhe duke referuar edhe nenin 332/a të Kodit Penal. Në datë 17/06/2017, Kryeministri Edi Rama u tërhoq nga deklarata e tij si dhe kërkoi ndjesë për reagimet e shkaktuara nga thirrja e tij. Baza ligjore e referuar: Neni 332/a Shpërdorimi i autoritetit policor (Shtuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

29. **20/6/2017- Zëvendës-kryeministria teknike, znj. Ledina Mandija** i kërkoi prokurorisë të niste veprimet hetimore ndaj kryebashkiakut të Vlorës, shtetasit Dritan Leli, me argumentin se shpërdoroi detyrën dhe pengoi subjektet politike gjatë fushatës zgjedhore të përdornin sheshin para Pallatit të Sportit “Flamurtari” në Vlorë, pasi ia kishte dhënë lejen vetëm një subjekti, konkretisht Partisë Socialiste, për periudhën dy mujore nga data 01/05/2017 – 30/06/2017. Baza ligjore e referuar: Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet” dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe Neni 330 “Pengimi i zgjedhësi”t (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017).

30. **20/6/2017 - Ministria teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina**, kallëzoi në prokurori shtetasen Sonila Peza, përgjegjësen e Zyrës Arsimore Kavajë, me akuzën se u përfshi në fushatën zgjedhore gjatë orarit zyrtar. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017).

20/06/2017 - Ministria e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina dërgoi pranë Komisionit Disiplinor, për shkeljet e përsëritura dhe të bëra publike më parë, të cilat janë regjistruar dhe verifikuar, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj drejtuesve apo përfaqësuesve të institucioneve arsimore, si më poshtë vijon:

- a. Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Kavajë,
- b. Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Bulqizë,
- c. Përgjegjës i Zyrës Arsimore Has,
- d. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Lezhë,
- e. Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Kurbin,
- f. Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Gramsh,
- g. Drejtori i Shkollës Iballë, Fushë Arrëz,
- h. Drejtori i Shkollës Gorre, Lushnje,
- i. Drejtori i Shkollës Nepravishtë, Gjirokastër,
- j. Drejtori i Shkollës së Mesme, Gramsh

31. **20/06/2017- Prokuroria e Tiranës** nisi hetimet ndaj Kryetarit të Bashkisë Kamzë, shtetasi Xhelal Mziu, me akuzën e kanosjes, pasi mori shkak nga një portal informativ sipas të cilit kryetari Mziu kanosi se do të prishte shtëpitë e të gjithë banorëve në Kamzë, të cilët mbanin flamuj të subjekteve politike PS dhe LSI gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Baza ligjore e referuar: Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

32. **21/06/2017- Ministri teknik i Punëve të Brendshme, z. Dritan Demiraj**, i kërkoi Komandantit të Gardës së Republikës shkarkimin e menjëhershëm nga detyra të efektivit Florian Lala, me motivacionin se mori pjesë aktive në fushatën elektorale të subjekti politik PDIU, në qarkun e Dibrës. Efektivi Florian Fatbardh Lala u lirua menjëherë nga detyra. Baza ligjore e referuar: Neni 332 Shpërdorimi i autoritetit ushtarak

33. **21/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazment Bardhi**, shkarkoi nga detyra Drejtorin e IEVP Berat, shtetasin Arif Dervishi, me motivacionin e përdorimit të

veprimtarisë së institucionit për qëllime politike, pjesëmarrje të paligjshme në fushatë zgjedhore dhe keq-menaxhim të institucionit. ”. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 248 Shpërdorimi i detyrës (Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

21/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazment Bardhi, shkarkoi nga detyra Drejtorin e IEVP Kavajë, shtetasin Durim Perja, me motivacionin e përdorimit të veprimtarisë së institucionit për qëllime politike, pjesëmarrje të paligjshme në fushatë zgjedhore dhe keq-menaxhim të institucionit. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 248 Shpërdorimi i detyrës (Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

34. **21/06/2017 – Zëvendës-kryeministrja teknike, znj. Ledina Mandija**, kallëzoi në Prokurorinë e Përgjithshme Shoqërinë “Albpetrol”, për punësimet e paligjshme të kryera në kohën e fushatës zgjedhore, gjatë muajve maj dhe qershor 2017. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

21/06/2017 – Zëvendës-kryeministrja teknike, znj. Ledina Mandija, kallëzoi në Prokurorinë e Përgjithshme, Ujësjetllësin Durrës për punësimet e paligjshme të kryera në kohën e fushatës zgjedhore, gjatë muajve maj dhe qershor 2017. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

21/06/2017 - Zëvendës-kryeministrja teknike, znj. Ledina Mandija, kallëzoi në Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave për punësimet e paligjshme të kryera në kohën e fushatës zgjedhore, gjatë muajve maj dhe qershor 2017. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

22/06/2017 - Zëvendës-kryeministrja teknike, znj. Ledina Mandija, i kërkoi Prokurorit të Përgjithshëm, të niste hetimin ndaj veprimeve të drejtuesve të shoqërisë Posta Shqiptare sh.a, të cilët, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, lëvizën në mënyrë të pajustificuar punonjës në qendër e në rrethe. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) si dhe Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) (1)

35. **22/06/2017 – Ministrja teknike e Financave, znj. Helga Vukaj**, kërkoi marrjen e masave dhe procedim të menjëhershëm disiplinor për 44 punonjës të administratës, për shkak të thyerjes së urdhërimit për mos angazhimin në zgjedhje. Sipas Ministrisë

së Financave, ata cënuan standardin zgjedhor dhe mbajtjen larg të administratës dhe keqpërdorimit politik. Dokumentacioni iu përcoll Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë si dhe FAF sha. Nuk ka informacione mbi identitetin e të personave.

36. **23/06/2017**- Burime nga ***Policia Shkodër*** raportuan se në Lagjen “Liria”, në një zyrë elektorale, po bëhej shpërndarje pakosh me ushqime, në këmbim të blerjes së votave. Shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër konstatuan në kushtet e flagrancës, nga këqyrja e zyrës elektorale, rreth 70 pako në qese plastmasë me artikuj ushqimor. Ato shpërndareshin nga kryetari lokal i një subjekti politik, shtetasi P. Rr. 49 vjeç, banues në Shkodër. Materialet i janë dërguar prokurorisë. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

23/06/2017- Burime nga ***Policia Shkodër*** raportuan se në Lagjen “Liria”, në një zyrë elektorale, po bëhej shpërndarje pakosh me ushqime, në këmbim të blerjes së votave. Shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër konstatuan në kushtet e flagrancës, nga këqyrja e zyrës elektorale, rreth 70 pako në qese plastmasë me artikuj ushqimor. Ato shpërndareshin nga shtetasi S. Gj, 29 vjeç, lindur në Tropojë dhe banues në lagjen “Skënderbeg”, Shkodër. Materialet i janë dërguar prokurorisë. Baza ligjore e mundshme: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

23/06/2017 - Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Shkodër arrestuan në flagrancë duke shpërndarë çeçe në para, pesë persona. Ata konstatuan një automjet me targë AA 147 NC, tip ‘Ford’ me ngjyrë të bardhë me logo dhe në pronësi të KESH Tiranë. Në mjet u gjetën shtetasi A. Gj., 48 vjeç, banues në Tiranë, me detyrë ekonomist në Drejtorinë Ekonomike të KESH, së bashku me shtetasit A. P, G. L, P. Ll. Dhe N. N.Gjatës deklaramëve, shtetasi A. Gj, pohoi se prej rreth një muaji ishte autorizuar nga Korporata Energjetike Shqiptare të kryente shpërndarjen e dëmshpërblimeve në zonat e përmbytura për rrethin e Shkodrës sipas VKM-së nr 842 datë 16.12.2011 dhe urdhrin Nr. 150 datë 18.04.2017 të Ministrit të Energjetikës.Ai me vete kishte dhe listën e personave përfitues të dëmshpërblimeve, në të cilën figuronin dhe shtetasit e lartpërmendur. Materialet iu referuan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Baza ligjore e mundshme: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

37. **24/06/2017 - Policia e Kukësit** u njoftua se në fshatin Novosej, në një lokal, hynë disa persona të pa identifikuar, të cilët janë konfliktuar me fjalë me Administratorin e Njësisë Administrative Shishtavec, shtetasin A.N.Në konflikt u përfshi edhe vetë pronari i lokalit shtetasi D.T, i cili u ka kërkuar personave që po debatonin, të dilnin jashtë nga lokali i tij, por u godit me grushta nga këta të fundit, ku njëri prej tyre ka qëlluar një herë me armë zjarri pistoletë në tavan të lokalit. Baza ligjore e mundshme: Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

38. **24/06/2017 - Policia e Shkodrës** arrestoi në flagrancë, shtetasin Izmir Bushaj, me profesion doganier, të cilit iu gjet një listë votuesish dhe një sasi kartëmonedhash. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017).

24/06/2017 - Policia e Shkodrës arrestoi në flagrancë, shtetasin Xhyher Bushaj, të cilit iu gjet një listë votuesish dhe një sasi kartëmonedhash. Ai ishte duke bashkëpunuar me kushëririn e tij, shtetasin Izmir Bushaj. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) (shih rastin 57)

39. **24/06/2017- Prefekti i Kukësit**, shtetasi Liman Morina, u kallëzua në Prokurorinë e Rrethit Kukës, pasi dyshohej se konsumoi në zyrën e tij, veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe shitblerjes së votës. Një qytetar, identiteti i të cilit nuk bëhet publik, pretendoi përpara organit të prokurorisë, se kishte një inçizim të prefektit Morina, duke i ofruar para dhe udhëzime për votimin. Materiali u mor në dorëzim nga prokuroria. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017).

40. **24/06/2017- Policia e Shkodrës** po kryen veprimet procedurale në gjendje të lirë për kryetarin e PSD, shtetasin Përparim Zeqir Raboshta, sepse në lagjen “Liria”, te zyra e PSD, po shpërndante 70 pako në qese plasmasi, me vaj, sheqer, miell, sapunë e detergjente, në këmbim të blerjes votave. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017).

24/06/2017- Policia e Shkodrës procedoi në gjendje të lirë kryetarin e PSD, shtetasin Saimir Ndokë Gjonpalajn, sepse në lagjen “Liria”, te zyra e PSD, po shpërndante 70 pako në qese plasmasi, me vaj, sheqer, miell, sapunë e detergjente, në këmbim të blerjes votave. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017).

41. **24/06/2017- Policia e Vlorës** nisi verifikimin ndaj shtetasve A. A, N. H dhe G. O, banues në Vlorë, pas disa informacionesh se kryenin veprime me qëllim blerjen e votave për subjekte elektorale. Të tre këta shtetas ushtronin presion tek zgjedhësit duke iu ofruar para në shkëmbim të votës. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

42. **24/06/2017-** Një qytetar me identitetin **Sh. Xeka** denoncoi shtetasin Daut Xeka, banues në fshatin Luz i Vogël, Kavajë. Përpara policisë së Kavajës qytetari deponoi se shtetasi i sipërpërmendur i ofroi 5000 lekë, për të kërkuar votë në 25 qershor për një subjekt politik.. Ai i ka përcjellë “të fala nga Altini”. Baza ligjore e referuar: Neni

328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

43. **24/06/07- Policia e Gjirokastrës** bëri me dije se zbardhi rastin e blerjes së votave u nga një person 57-vjeçar, por për arsye hetimi, nuk dha të dhëna mbi identitetin e autorit. Materialet në ngarkim të tyre iu referuan prokurorisë. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

24/06/07- Policia e Gjirokastrës bëri me dije se zbardhi rastin e blerjes së votave u nga një person 30-vjeçar, por për arsye hetimi, nuk dha të dhëna mbi identitetin e autorit. Materialet në ngarkim të tyre iu referuan prokurorisë. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

44. **24/06/07-** Burime nga **Shërbimi Informativ Shtetëror** bënë të ditur se pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Drejtorisë së Policisë Elbasan u depozitua një material hetimor në ngarkim të shtetasit Dashmir Xhika, përfaqësues i LSI, banues në Cërrik. Sipas materialit të referuar në prokurori, ai premtonte shuma parash në këmbim të votës për zgjedhjet e datës 25 Qershor, për një subjekt politik, në disa zona të qytetit Cërrik dhe fshatrat përreth. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

24/06/07- Burime nga Shërbimi Informativ Shtetëror bënë të ditur se pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Drejtorisë së Policisë Elbasan u depozitua një material hetimor në ngarkim të shtetasit Shkëlqim B., banues në Cërrik. Sipas materialit të referuar në prokurori, ai premtonte shuma parash në këmbim të votës për zgjedhjet e datës 25 Qershor për një subjekt politik, në disa zona të qytetit Cërrik dhe fshatrat përreth. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

45. **24/06/07-** Specialistët e **Komisariatit të Policisë Kavajë** shpallën në kërkim shtetasin A. S., 59 vjeç, banues në Kavajë. Ky shtetas u denoncuan në ambientet e Komisariatit të Policisë Kavajë, nga shtetasi T. P., 24 vjeç, banuese në Kavajë. Ai deklaroi se në vendin e njohur si “nënstacioni elektrik”, në lagjen nr.2 Kavajë, pranë tij ndaloi një automjet nga ku zbriti shtetasi A. S., i cili e qëllloi dhe e kërcënoi se mbas zgjedhjeve do të kishte probleme. Materialet procedurale i kaluan prokurorisë në Kavajë. Baza ligjore e referuar: Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

24/06/07 - Specialistët e Komisariatit të Policisë Kavajë shpallën në kërkim shtetasin B. Xh., 30 vjeç, banues në Kavajë. Ky shtetas u denoncuan në ambientet e Komisariatit të Policisë Kavajë, nga shtetasi T. P., 24 vjeç, banuese në Kavajë. Ai deklaroi se në vendin e njohur si “nënstacioni elektrik”, në lagjen nr.2 Kavajë, pranë tij ndaloi një automjet nga ku zbriti shtetasi B. Xh., i cili e kërcënoi se mbas

zgjedhjeve do të kishte probleme. Materialet procedurale i kaluan prokurorisë në Kavajë. Baza ligjore e referuar: Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

DITA E VOTIMIT 25/06/2017 (në rend kronologjik)

46. 25/06/07- Shtetasi F.S me banim në Vlorë bëri denoncim pranë policisë, se rreth orës 09:30, u paraqit për të votuar në Qendrën e Votimit Nr. 4489 në lagjen “1 Maji” Vlorë dhe nuk mundi të ushtrojë të drejtën e votës duke fajësuar për këtë, Komisionin e Qendrës së Votimit. Sipas tij, në listat e votuesve rezultoi se me të dhënat e këtij shtetasi ishte kryer njëherë votimi më parë. Në lidhje me këtë rast, policia njoftoi se kreu veprimet e para hetimore. Baza ligjore e referuar nga Policia: Neni 326 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013) dhe Neni 327/a Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
47. 25/06/07- Burime policore të Policisë së qytetit Korçë njoftuan se shtetasi Andimiano Ravolli u arrestua sepse votoi dy herë. Ky shtetas ishte komisioneri i qendrës së votimit me Nr. 3736 në fshatin Barç. Ai u ndalua në flagrancë në qendrën e votimit. Baza ligjore e referuar: Neni 327/a/2 Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
48. 25/06/07- Në qendrën e votimi Nr. 2345 në qytetin e Elbasanit, u dhunua vëzhguesi i PS, shtetasi Arben Kërçyku. Rasti është referuar në polici. Nuk ka të dhëna nëse materialet i janë referuar prokurorisë përkatëse. Baza ligjore e referuar: Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
49. 25/06/07 - Forcat e Policisë Kavajë ndërhyjnë në qendrën e numërimit nr.42 në shkollën “3 Dëshmorët”,për të neutralizuar një përplasje fizike midis numëruesve, vëzhguesve dhe komisionerëve të LSI-së dhe PS-së. Nuk ka të dhëna për referime të veprës penale për hetim të mëtejshëm në prokurori. Baza ligjore e mundshme: Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
50. 25/06/07 - Zyra e shtypit të LSI raportoi dhunën e ushtruar nga goditja me levë në kokë e një vëzhgues të saj, shtetasit Elvi Cullhaji në Kërrabë, nga shtetasi Arjan Alldervishi, administrator i PS Kërrabë, së bashku me 6 persona. Nuk ka të dhëna nëse prokuroria nisi një hetim mbi këtë ngjarje. Baza ligjore e referuar: Neni 329/2 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
51. 25/06/07 - Në qendrën e votimit Nr. 3665/1 në Korçë, Komisioni i Qendrës së Votimit kërkoi ndërhyrjen e policisë, pasi një nga anëtarët e komisionit konstatoi një person, i

cili po fotografonte votën e tij. Shërbimet e Policisë, nga kryerja e veprimeve të para hetimore, bënë me dije se shtetasi E.K, 29 vjeç, banues në Korçë, pasi u regjistrua, mori fletën e votimit dhe shkoi tek vendi i fshehtë, ku bëri fotografimin e fletës së votimit. Ky veprim u pa nga anëtarët e komisionit. Personit të mësipërm iu bllokua fleta e votimit dhe në atë moment, u larguar menjëherë nga qendra e votimit. Nga ana e Policisë, në konsultim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, u kryen veprimet e para procedurale, me qëllim kapjen e autorit. Baza ligjore e referuar: Neni 327/1 Shkelja e fshehtësisë së votimit (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) U kërkua ndërhyrja e Policisë

52. 25/06/07 - LSI denoncoi sjelljen e Policisë së Rrethit Korçë, e cila në shkelje flagrante, arrestoi një komisioner të këtij subjekti politik, me qëllim ndërprerjen e procesit të votimit. Nuk ka të dhëna të mëtejshme nëse është nisur një hetim mbi këtë ngjarje. Baza ligjore e referuar: Neni 332/a Shpërdorimi i autoritetit policor (Shtuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
53. 25/06/07 - Deputeti i PD Ervin Salianji denoncoi dhunën e ushtruar ndaj përfaqësuesit të PD në Rrembec të Korçës, shtetasit Theodor Thimo, i cili u rrah para qendrës së votimit nga përfaqësuesit e PS, shtetasit Sotiraq dhe Julian Tore. Nuk ka të dhëna të mëtejshme nëse policia ka nisur hetim mbi këtë ngjarje. Baza ligjore e referuar: Neni 329/2 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
54. 25/06/07 – Shtetasi Pajtim Myrtollari, koordinator i LSI-së në një lagje të Korçës, përfundoi në pranga ditën e zgjedhjeve, me akuzën se po tentonte të blinte vota në favor të LSI, ndërkohë që iu gjetën prova materiale si dhe disa transaksione bankare. Ai ishte arrestuar për të njëjtën akuzë edhe në zgjedhjet e vitit 2013, por gjykata e shkallës së parë e kishte shpallur të pafajshëm, ndërsa akuza ishte amnistuar ndërkohë që çështja e tij ndodhej në Apel. Avokati i Myrtollarit e cilësoi akuzën si politike. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
55. 25/06/07 - Në një qendër votimi në Orman, Korçë, u konstatua rasti i një votimi familjar. Nuk ka të dhëna të mëtejshme nëse është nisur një hetim mbi këtë ngjarje nga Policia e Korçës. Baza ligjore e referuar: Neni 327/a/1 Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
56. 25/06/07 – Shtetasi Florian Bushku, aktivist i LSI u plagos ditën e zgjedhjeve pranë një qendre votimi në Shëngjin, pas një sherri me armë. Sipas Policisë, Bushku u qëllua me qytë arme, ndërsa pranë qendrës së votimit pati edhe të shtëna. Baza ligjore e referuar: Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
57. 25/06/07 – Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nisi procedimin penal ndaj shtetasit Damjan Ndoka, pasi kishte element prove se ky shtetas po kanoste pjesëmarrësit në zgjedhje. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë caktoi masën e sigurisë me Vendimin Penal datë 28/06/2017, ndaj shtetasit Ndoka. Baza ligjore e referuar: Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

58. 25/06/07 – Policia e Tiranës arrestoi kreun e PS-së së Vorës, Arben Marku pasi u filmua nga emisioni ‘Stop’ duke blerë vota. Arrestimi i tij u bë pasi nga pamjet filmike të shfaqura në emisionin investigativ “Stop”, në televizionin Klan, pasqyrohen veprimet korruptive të shtetasit Arben Marku, i cili në këmbim të blerjes së votës jep një shumë monetare. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
59. 25/06/07 – Policia e Tiranës arrestoi shtetasin Luan Imeraj, i cili ishte edhe përkrahës i një subjekti politik, pasi u filmua nga emisioni ‘Stop’ duke blerë vota. Arrestimi i tij u bë pasi nga pamjet filmike të shfaqura në emisionin investigativ “Stop”, në televizionin Klan, pasqyrohen veprimet korruptive që e inkriminonin. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
60. 25/06/07 – Policia e Tiranës arrestoi shtetasin Luan Nelaj, pasi u filmua nga emisioni ‘Stop’ duke blerë vota. Arrestimi i tij u bë pasi nga pamjet filmike të shfaqura në emisionin investigativ “Stop”, në televizionin Klan, pasqyrohen veprimet korruptive që e inkriminonin. Pasi u kryen hetimet, Specialistët e Seksionit për Hetimin e Korrupsionit, dokumentuan me prova ligjore se Luan Nela, përfitoi shumë e parave në këmbim të votës. Nga hetimet e kryera rezultoi gjithashtu se Luan Nela pranoi të bëjë regjistrimet audio dhe video në këmbim të një vendi pune të premtuar nga Luan Imeraj i cili ishte edhe përkrahës i një subjekti politik. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Baza ligjore e referuar: Neni 328/b Korrupsioni pasiv në zgjedhje (Shtuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
61. 25/06/07 - Në fshatin Fatish, Peqin, një person me inicialet A.M hyri brenda qëndrës së votimit Nr. 2287 dhe goditi me grusht sekretarin e komisionit. Pas ndërhyrjes së forcave të rendit, nisën procedurat për kapjen e autorit. Baza ligjore e referuar: Neni 329/2 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
62. 25/06/07- Disa foto të publikuara nga LSI tregojnë sesi ndaheshin lekë në fshatrat Rrapëz dhe Bubullimë të Lushnjës. Në foto dalloheshin qese jeshile që nuk dihet se me çfarë kanë qenë të mbushura dhe u janë shpërndarë banorëve. Nuk ka informacion nëse materialet i janë referuar prokurorisë. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
63. 25/06/07- Anëtarja e KZAZ Nr. 41 në Tiranë, Luljeta Lleshi, e propozuar nga subjekti politik PS, u përjashtua nga komisioni pasi u akuzua se futi fletë votimi nga jashtë brenda në KZAZ. Nuk ka të dhëna të mëtejshme nëse është nisur një hetim mbi këtë ngjarje nga organi i akuzës. Baza ligjore e referuar: Neni 326 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

64. 25/06/07- Nënkryetari i PD Edmond Spaho publikoi një video denoncuese, në të cilën konstatohej mënyra e shitblerjes së votat më 25 qershor, nga bashkëbisedimi i dy personave. Nuk ka informacion të detajuar mbi identitetin dhe aksionet e autoriteteve ligj-zbatuese. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
65. 25/06/07- Seksioni i Hetimit të Krimit Ekonomik e Financiar në Komisarriatin e Vlorës shpalli në kërkim shtetasin R.M., 54 vjeç, banues në Vlorë, pas denoncimit të bërë nga KZAZ Nr. 82, në të cilin thuhej se ky shtetas fotografoi fletën e votimit. Kur ky veprim është konstatuar nga anëtarët e Komisionit të qendrës së votimit Nr. 4495/1, autori dëmtoi (grisi) fletën e votimit dhe më pas u largua nga qendra e votimit. Baza ligjore e referuar: Neni 327/1 Shkelja e fshehtësisë së votimit (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
66. 25/06/07- Forcat e Rendit në Delvinë nisën hetimin pas denoncimit të kandidatit për deputet Reni Brajami. Burime nga policia bënë me dije se në qendrën e votimit Nr. 4619, pranë spitalit, ai pa një shtetase, e cila hodhi në tokë jashtë qendrës së votimit, 2 fletë të ngjashme si fletët e votimit dhe pretendon se ato janë imituese ose të falsifikuara. Policia bëri të mundur sekuestrimin e fletëve të konstatuara (2 copë), të cilat iu nënshtruan ekspertizës për përcaktimin e saktë të tyre. Nuk ka të dhëna mbi identitetin e autorit. Baza ligjore e referuar: Neni 326/1 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)
67. 25/06/07 - LSI denoncoi shtetasin Agron Sulejmani, votues në qendrën e votimit Shkolla e Muzikës si dhe koordinatori i PS i lagjes nr. 3, pasi sipas kësaj të fundit, po shpërndante para në këmbim të votave. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
68. 25/06/07 - LSI denoncoi një incident të ndodhur në lagjen Nr.18, Durrës, pasi sipas kësaj të fundit, disa anëtarë të PS u përpoqën të sulmonin simpatizantët e LSI, për t'i intimiduar dhe mos lejuar të shkonin në votim. Nuk ka të dhëna mbi identitetin e personave të denoncuar. Baza ligjore e referuar: Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
69. 25/06/07 - LSI denoncoi shtetasin Ledian Lako, përfaqësues të PS Durrës, pasi sipas kësaj të fundit, po shpërndante para në këmbim të votave. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
70. 25/06/07 - Drejtoria e Policisë Elbasanreferoi materialet në prokurori, për shtetasin Fatmir Qemal Gjeçi, banues në Tiranë, sepse në fshatin Zdrajsh, duke lëvizur me mjetin tip “Mitsubishi”, me targë TR 4921 R, dyshohej se do të shpërndante para për blerje votash në favor të një subjekti politik. Baza ligjore e referuar: Neni 328

Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

71. 25/06/07 - Drejtoria e Policisë Fierreferoi materialet në prokurori, për shtetasin me iniciale B.C. Nuk u dhanë të dhëna të tjera, pasi procedimi ndiqej me metoda speciale hetimi. Gjatë kontrollit iu gjendën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 24.500 lekë. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
72. 25/06/07 - Seksioni kundër krimit ekonomik e financiar Krujëreferoi materialet në prokurori, për shtetasin Besmir Karaj, pasi po u shpërndante vlera monetare personave të ndryshëm, anëtarë të komisioneve e vëzhguesve të subjekteve politik që aderonte. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
73. 25/06/07 - Komisariati i Policisë Elbasan referoi materialet në prokurori, për shtetasin Afrim Jagodina, banues në Elbasan, pasi dyshohej se ky shtetas do të shpërndante para për blerje votash në favor të një subjekti politik. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
74. 25/06/07 - Në Komisarlatin e Policisë Cërrik, qytetari Servet Ramazan Duzha, kryetar i një subjekti politik, dega Cërrik, denoncoi shtetasin Xhulio Hasko, banues në Cërrik, pasi në lagjen nr. 3, ky shtetas me mjetin e tij tip “Benz”, me targa AA010 HM, po shpërndante pako me ushqime në këmbim votash në favor të një subjekti politik. Policia njoftoi se i referoi materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
75. 25/06/07 - Seksioni kundër krimit ekonomik e financiar Krujëreferoi në prokurori materialet për shtetasin Rexhep Rraja, banues në fshatin Nikël, sepse në bashkëpunimin me dy shtetas të pidentifikuar, kanosën me fjalë e armë zjarri dhe goditën me grushte shtetasin Besmir Karaj, për motive lidhur me procesin zgjedhor. Baza ligjore e referuar: Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
76. 25/06/07 - Subjekti politik LSI denoncoi aktin kriminal në Ksamil, Sarandë ku makina me targa AA 602 MI, e tipit Lanca, në pronësi të shtetasit Ilir Hysi, me 3 anëtarë të PS, po shpërndanin lekë ndaj banoreve në këmbim të votës. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
77. 26/06/07 - Specialistët e Sektorit kundër Krimit Ekonomik-Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, kapën dhe arrestuan në flagrancë shtetasin :· P. M., 55 vjeç, banues në Korçë, me detyrë specialist pranë Drejtorisë së Peshkimit Korçë, koordinator i një subjekti politik. Ky shtetas, u kap duke shpërndarë shuma lekësh me qëllim blerjen e votës, deri në 20000 lekë, për një subjekt të caktuar politik. Baza

ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

78. 26/06/07 - Specialistët e Sektorit kundër Krimit Ekonomik-Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, kapën dhe arrestuan në flagrancë shtetasin R.D, 61 vjeç, banues në Korçë, me detyrë koordinator i një subjekti politik. Ky shtetas u kap duke shpërndarë shuma lekësh me qëllim blerjen e votës për një subjekt të caktuar politik. Baza ligjore e referuar: Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
79. 29/06/07 - Kandidati i PD Fitim Zekthi në Qarkun e Elbasanit, ngriti akuza për manipulim të rezultatit, pasi në një fshat të Elbasanit, nuk mori as votat e komisionerëve të po këtij subjekti politik. Nuk ka të dhëna mbi identitetin e personave të akuzuar apo nëse ka nisur një procedim penal. Baza ligjore e referuar: Neni 326/2 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)
80. 01/07/07- LIBRA publikoi një tjetër rast të vjedhjes së votave të kandidatit të saj, Mystehak Muho në Memaliaj. Ai votoi bashkë me familjarët e vet, gjithsej 6 veta në mjedisin e Pallatit të Kulturës, qendra Nr. 4369/1 dhe nuk mori asnjë votë në rezultatin e numërimit. Baza ligjore e referuar: Neni 326/2 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)
81. 09/07/07 – Znj. Mesila Doda publikoi një video ku denonconte vjedhjen e votave të PDIU. Nuk ka të dhëna të mëtejshme nëse është nisur një hetim mbi këtë ngjarje. Baza ligjore e referuar: Neni 326/2 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)
82. 09/07/07 - Kreu i PDIU, z. Shpëtim Idrizi bëri deklarata publike, pas konstatimit se mungojnë pamjet filmike në 100 qendra votimi dhe në rreth 50 qendra pamjet janë të padallueshme, në kundërshtim me ligjin. Në shumë procesverbale ka mospërputhje të theksuar të votave të vlefshme me votat për subjekte të ndryshme, prapë në disfavor të subjektit PDIU. Nuk ka të dhëna të mëtejshme nëse është nisur një hetim mbi këtë ngjarje. Baza ligjore e referuar: Neni 326/2 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)
83. 14/07/2017 - z. Ben Blushi publikoi një video ku sipas tij, vidheshin votat e subjektit politik Libra nga numëruesit e partive politike PD, PS por edhe të partive të tjera LSI dhe PDIU, të cilat tjetërsonin votat e subjektit të tij politik. Bëhet fjalë për vjedhjen e mbi 40 votave të LIBRA në 7 kuti, në Njësinë nr. 8 në Tiranë, KZAZ nr. 38 tek Shkolla e Kuqe. Numëruesit e KZAZ nr. 38 ishin nëpunës të administratës shtetërore.

Njëri prej tyre quhej Ergys Hilanga PS. Ai kryente funksionin si Shef Finance në Ministrinë e Mbrojtjes. Një tjetër numërues i kësaj KZAZ ku janë vjedhur votat e LIBRA, quhej Florian Shkreta, anëtar i LSI. Ai punonte pranë Drejtorisë së Hipotekave. Dy numëruesit e tjerë janë Mirand Seferi dhe Elona Filolli. Kjo e fundit ishte anëtare e PDIU dhe punonte pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. LIBRA mori me vonesë dhe me probleme pamjet filmike të numërimit nga KQZ. Kjo bëri që të digjeshin afatet për ankimim në Kolegjin Zgjedhor. Këta të katër siç provohet nga pamjet filmike të KQZ-së i vodhën subjektit politik LIBRA, 18 vota në dy kuti, respektivisht QV Nr. 1939 ZAZ 38 dhe QV Nr.19 44/2 ZAZ 38. Nuk ka të dhëna të mëtejshme nëse është nisur një hetim mbi këtë ngjarje. Baza ligjore e referuar: Neni 326/2 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013).

84. 14/07/2017- LSI kallëzoi në prokurori komisionerët e qendrës së votimit Nr. 1079, në Moçinë të Bulqizës, pasi i akuzonte ata për vjedhje dhe manipulim votash. Nuk ka të dhëna të mëtejshme nëse nisi një hetim mbi këtë ngjarje. Baza ligjore e referuar: Neni 326/2 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013) dhe Neni 327/a Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
85. 19/07/2017- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kallëzoi penalisht 76 anëtarë dhe numërues të parë të grupeve të numërimit, pasi shqyrtoi dy ankimmimet e paraqitura nga partitë politike, PDIU dhe PS, të cilat kundërshtuan rezultatin e votimit për disa zona zgjedhore në qarkun Tiranë, duke kërkuar rinumërimin e rivlerësimin e votave për 64 qendra votimi, me pretendimin se numri i votave reale nuk përputhej me rezultatin e hartuar nga Grupet e Numërimit në tabelat e qendrave të votimit. Edhe pse ndryshimet e konstatuara në tabelat e rezultatit nuk sillnin pasoja në rezultat apo në pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore, Kryetari i KQZ, z. Klement Zguri, fajësoi direkt partitë politike se nxitën numëruesit për tjetërsimin e votave. Por ai theksoi, se kjo ishte një bindje e tija dhe i ngelet Prokurorisë për ta vlerësuar. Baza ligjore e referuar: Neni 326/2 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)
86. 23/07/2017- Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi një rast të përfshirjes në fushatën elektorale të Partisë Socialiste, të efektivit të policisë Dedë Kodra, me funksion ndihmës Specialist i Policimit në Komunitet, në Komisaratin e Policisë Shkodër. Pas këtij denoncimi reagoi Komisarati i Policisë së Shkodrës, i cili shkarkoi nga detyra efektivin. Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave nisi hetimin për këtë rast. Neni 332/a Shpërdorimi i autoritetit policor (Shtuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

Shtojca 3 - Shkarkimet nga puna

A - Shkarkimet nga puna në rend kronologjik

1. 01/06/2017 - Ministri teknik i Brendshëm, z. Dritan Demiraj, shkarkoi nga detyra drejtorin e policisë në Vaun e Dejës, që kërcënoi reporterin e PD dhe shoferin e tij. Nuk ka të dhëna mbi identitetin e autorit.
2. 02/06/2017 - Ministrja teknike e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, znj. Xhuljeta Kërtusha, shkarkoi me motivacionin se mori pjesë në fushatën e PS, Drejtoreshën e Zyrës së Punës në Tiranë, Marisa Kaçori. Nga ana tjetër, Marisa Kaçori i kërkoi që të faktojë me prova se kur ka qenë në fushatën e PS-së. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
- b. Marisa Kaçori ka kërkuar nga ministrja teknike e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Xhuljeta Kërtusha që të faktojë kur ka qenë në fushatën e PS-së. Ajo shprehet se nuk mori asnjë shkresë zyrtare në lidhje me propozimin e ministres për shkarkim nga puna. Nga kontakti që pati edhe me Drejtorin e Përgjithshëm, as ai nuk ka marrë asnjë shkresë zyrtare. Lajmërimin për shkarkim nga puna e ka mësuar nga media. Ajo i kërkoi ministres teknike të faktonte me foto bashkë me orarin përkatës në të cilin ato janë shkrepur. Kjo pasi në bazë të urdhrin të kryeministrit, punonjësit e administratës publike mund të merrnin pjesë në fushatë pas orarit zyrtar të punës.

03/06/2016 - Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, shkarkoi:

3. Drejtorin e IEVP Fier, z. Jetnor Krakulli, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim e ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Jetnor Krakulli, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
4. Regjistruetin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, z. Ani Dyrmishi, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Ani Dyrmishi, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
5. Drejtorin e IEVP Lezhë, z. Eduart Kurti, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”

(Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

6. Regjistruerin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, znj. Adriana Shehu, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasës Adriana Shehu, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Gjithashtu, sipas medias ndaj kësaj shtetaseje është kërkuar nga gjykata marrja e masës së sigurimit personal “arrest me burg”. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
7. Drejtorin e IEVP Rrogozhinë, z. Ahmet Bala, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
8. Drejtorin e IEVP Burrel, z. Fatjon Kurti, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Fatjon Kurti, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
9. Kryetarin e Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Durrës, z. Surin Hoxha, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Surin Hoxha, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
10. Drejtorin e IEVP “Jordan Misja” (nr.313), z. Fatjon Fana, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
11. Drejtorin e IEVP në Tropojë, z. Granit Kurmekaj, për përfshirje në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Granit Kurmekaj, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)

12. Regjistruesin e Zyrës se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Shkodër, z. Edmond Ndou, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”.Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
13. Regjistruesin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, z. Ledian Shehu për përdorim të funksionit publik për veprimtari zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Ledian Shehu, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”.Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
14. 05/06/2017 - Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, shkarkoi kreun e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Policisë së Burgjeve, shtetasin Ramazan Topuzi, me motivacioni se emërimi në këtë detyrë ishte bërë në kundërshtim me ligjin. Shtetasi Ramazan Topuzi rezultoi i shkarkuar dy herë nga policia e shtetit, për shkelje të rëndë të detyrës, si cënim të figurës së punonjësit të policisë dhe për mosparaqitje në detyrë e mangësi të theksuara në kryerjen e detyrës. Veç këtyre dy rasteve të evidentuara edhe në shkresën zyrtare të policisë së shtetit, burimet nga prokuroria thonë se Topuzi në kohën që ushtronte profesionin e avokatit, pas vitit 2009 është kallëzuar dy herë, për akuzën e mashtrimit dhe atë të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj prokurorit dhe gjyqtarëve.
15. 05/06/2017 - Ministrja e Ekonomisë, znj. Milva Ikonomi, shkarkoi nga puna Drejtorin e Postës Majlind Lazimi, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”.Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017)
16. Ky i fundit, thotë se lirimi i tij nga detyra është akt i pastër politik, i paligjshëm, vetëm për arsye politike dhe nuk ka asnjë bazë ligjore. Në një prononcim për mediat ai ka theksuar se nuk është bërë presion ndaj asnjë punonjësi të Postës Shqiptare. Ish-drejtori i Postës Shqiptare Majlind Lazimi ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj ministres së Ekonomisë Milva Ikonomi për shkarkimin nga detyra, ndërsa paralelisht ka dërguar një padi edhe në Gjykatën Administrative.
17. 06/06/2017 – Ministri teknik i Shëndetësisë, z. Arben Beqiri, shkarkoi nga detyra e Drejtorit të Spitalit Rajonal Berat, Ildir Farshërin, gjatë një takimi me dyer të mbyllura me shefat e pavionëve, për kryerjen e veprës penale, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”.Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017). Ky i fundit deklaroi se lajmërimin për shkarkim nga puna e ka mësuar

nga media dhe do të shprehej kur t'i komunikohet zyrtarisht akuza për të cilën u përfol.

18. 06/06/2017 - Ministrja teknike e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, znj. Xhulieta Kërtusha, firmosi propozimin për largim nga puna të Gent Halilaj me detyrë Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Kukës, me motivacionin se kishte fakte që vërtetnin pjesëmarrjen në aktivitete të fushatës gjatë orarit zyrtar të punës.
19. 06/06/2017 - Ministrja teknike e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, znj. Xhulieta Kërtusha, propozoi largimin nga puna të shtetases Luiza Qipo, me detyrë Përgjegjëse e Agjensisë së Sigurimeve Shoqërore Ersekë, me arsyetimin se Qipo mori pjesë në fushatën elektorale të Partisë Socialiste gjatë orarit zyrtar të punës. Ky propozim i është drejtuar z. Astrit Hados, Drejtor i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
20. Ilirjan Muho u liruar nga detyra në postin e drejtorit të Hipotekave, duke u zëvendësuar nga Arjan Bylykbashin. Ky largim erdhi pas marrëveshjes politike të 18 Majit ndërmjet liderëve të PS, njëkohësisht kryeministër i vendit, z. Edi Rama dhe liderit të PD, z. Lulzim Basha, të ndërmjetësuar ndërkombëtarisht. Kjo marrëveshje krijoi mundësinë e zgjidhjes së ngërçit politik për një afat 3muajor, duke mundësuar PD, të emëronte në poste kyçe, ministra, zëvendëskryeministër dhe drejtues institucionesh.
21. Miklovan Kopani u liruar nga detyra në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, duke u zëvendësuar nga Arjan Hoxha. Ky largim erdhi pas marrëveshjes politike të 18 Majit ndërmjet liderëve të PS, njëkohësisht kryeministër i vendit, z. Edi Rama dhe liderit të PD, z. Lulzim Basha, të ndërmjetësuar ndërkombëtarisht. Kjo marrëveshje krijoi mundësinë e zgjidhjes së ngërçit politik për një afat 3muajor, duke mundësuar PD, të emëronte në poste kyçe, ministra, zëvendëskryeministër dhe drejtues institucionesh.
22. 08/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, pushoi nga puna shtetasin Neritan Çela, specialist në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive, me akuzën se ishte përfshirë në fushatën zgjedhore gjatë orarit zyrtar. Urdhri mban firmën e kryeregjistruesit Arjan Bylykbashi. Në të njëjtën kohë, shtetasi Neritan Çela rezultoi të jetë edhe bashkëshort i deputetes së LSI-së, Silva Caka.
23. 09/06/2017 – Ministrja teknike e Mirëqenies Sociale, znj. Xhuljeta Kërtusha, firmosi largimin nga puna të shtetasit Ervis Xhelo, me funksion Drejtor Rajonal i Sigurimeve Shoqërore Elbasan, i cili mbështeste subjektin politik PDIU, me akuzën se ishte përfshirë në fushatën zgjedhore gjatë orarit zyrtar.
24. 13/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, shkarkoi nga detyra drejtorin e burgut të Vlorës, shtetasin Bashkim Habilaj, me motivacion braktisje e detyrës dhe keq-menaxhim i institucionit. Zyrtarisht, Ministria e Drejtësisë thotë se drejtori i burgut Vlorë, “pa asnjë arsye të përligjur dhe pa asnjë njoftim, nuk paraqitet në detyrë prej disa ditësh. Kjo sjellje përbën braktisje të detyrës dhe është administrativisht dhe penalisht e dënueshme”. Baza ligjore e referuar: Neni 248 Shpërdorimi i detyrës (Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004;

ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

25. 13/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, shkarkoi nga detyra drejtorin e burgut të Fushë Krujës, shtetasin Albert Malaj, me motivacion braktisje e detyrës dhe keq-menaxhim i institucionit. Zyrtarisht, Ministria e Drejtësisë thotë se “nuk ka menaxhuar në mënyrë efektive stafin nën varësinë e tij, ku janë vërejtur mungesa të pajustifikuara; ka lejuar, nëpërmjet mosveprimit, futjen e sendeve të ndaluara në institucion, ku përfshihen jo vetëm telefona celular, por edhe pije të ndryshe alkoolike; ka lejuar, nëpërmjet mosveprimit, shkeljen e rregullave mbi oraret e regjimit të brendshëm, duke shkaktuar kaos në institucion, si dhe duke rrezikuar sigurinë; ka shkelur rregullat mbi kontraktimin e operatorëve tregtar që veprojnë brenda IEVP; si dhe ka shkelur rregullat e takimeve të lejuara midis të burgosurve dhe familjarëve të tyre, si dhe rregullat e akomodimit të të dënuarve”. Baza ligjore e referuar: Neni 248 Shpërdorimi i detyrës (Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)
26. 21/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazment Bardhi, shkarkoi nga detyra Drejtorin e IEVP Berat, shtetasin Arif Dervishi, me motivacionin e përdorimit të veprimtarisë së institucionit për qëllime politike, pjesëmarrje të paligjshme në fushatë zgjedhore dhe keq-menaxhim të institucionit. ”Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 248 Shpërdorimi i detyrës (Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)
27. 21/06/2017 – Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazment Bardhi, shkarkoi nga detyra Drejtorin e IEVP Kavajë, shtetasin Durim Perja, me motivacionin e përdorimit të veprimtarisë së institucionit për qëllime politike, pjesëmarrje të paligjshme në fushatë zgjedhore dhe keq-menaxhim të institucionit. Baza ligjore e referuar: Neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” (Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017) dhe Neni 248 Shpërdorimi i detyrës (Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

Shtojca 4 - Pezullimet nga puna

A. Pezullimet nga puna në rend kronologjik

1. 08/06/2017 - Ministri teknik i Drejtësisë, z. Gazmend Bardhi, pezulloi nga detyra shtetasen Juliana Hoxha, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, e cila garonte për një mandat deputeti në Qarkun Tiranë nën siglën e PS-së. Sipas ministrit teknik, Sekretari i Përgjithshëm është figura më e lartë e administratës publike në ministri apo institucionet e tjera shtetërore dhe aktiviteti politik ishte i papajtueshëm me këtë funksion.
 - b. *Ndërkohë që Departamenti i Administratës Publike ka rikthyer shtetasen Juliana Hoxha në detyrë dhe nuk e ka pranuar kërkesën për pezullim të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë duke e vlerësuar atë si të pabazuar. DAP ka vendosur përfundimin e procedurës për pezullim dhe vendimi hynte në fuqi menjëherë. Ndër të tjera thoshte se “nuk mund të vendoste pezullimin e një nëpunësi civil të kategorisë së lartë drejtuese, pa respektuar të drejtat e tij procedurale dhe dëgjuar atë”. Por Ministria e Drejtësisë deklaroi se nuk e njihte vendimin e DAP, për kthimin në detyrë të sekretares së shkarkuar të këtij dikasteri.*
2. 09/06/2017 - Ministria teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina, kërkoi pezullimin nga puna të Drejtoreshës së Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë, Albana Hodaj sepse kundërshtoi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 473, datë 01.06.2017. Ndërkohë, Plarent Ndreca, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve theksoi se nuk ka nisur asnjë procedurë pezullimi apo shkarkim. Ai shtoi se administrata publike mbrohet nga ligji për nëpunësin civil të miratuar me konsensus të gjerë politik. Pezullimi dhe largimi i nëpunësve civil bëhet bazuar në procedurat e parashikuara me ligj.
3. 06/06/2017 – Ministri teknik i Shëndetësisë, z. Arben Beqiri bazuar në informacionet dhe ankesat e bëra në drejtim të Ministrit për pjesëmarrje aktive në fushatë zgjedhore, mori masë për pezullimit nga detyra për shtetasin Bledar Hima, Drejtor i shërbimit spitalor Librazhd.
4. 13/06/2017 - Ministria teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina, urdhëroi pezullimin e menjëhershëm nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse, z. Alqi Kushi, me urdhrin Nr. 355, për shkak të mospërbushjes së detyrave funksionale që sollën pasoja shumë të rënda në mbarëvajtjen e punës së institucionit.
 - b. *Departamenti i Administratës Publike rrëzoi kërkesën për pezullimi nga detyra të z. Alqi Kushi. DAP bashkë me shërbimin civil argumentuan se kanë hedhur poshtë urdhrin e Ministres se Arsimit dhe Sportit, Mirela Karabina, për pezullimin nga detyra të drejtorit të Përgjithshëm të MAS, z. Alqi Kushi. DAP tha se vendimi për pezullimin e zyrtarëve të MAS nga ana e Ministres së Arsimit është i pavlefshëm dhe është nxjerrë në tejkallim të kompetencave pasi nuk respekton procedurat ligjore. Komisioneri për mbikëqyrjen e shërbimit civil deklaroi se Ministria e Arsimit dhe Sportit bazuar në ligj, duhet të rikthejë në detyrë z. Alqi Kushi. Edhe DAP, sikundër KSHC, e cilëson aktin e Ministres absolutisht pa vlerë juridike.*

5. 13/06/2017 - Ministrija teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina, urdhëroi pezullimin e menjëhershëm nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit, znj. Ornela Koleka, me urdhrin Nr. 342, për shkak të mospërmbushjes së detyrave funksionale që sollën shumë të rënda në mbarëvajtjen e punës së institucionit.¹⁰
 - b. *Departamenti i Administratës Publike rrëzoi kërkesën për pezullimi nga detyra të znj. Ornela Koleka. DAP bashkë me shërbimin civil argumentuan se kanë hedhur poshtë urdhrin e Ministres së Arsimit dhe Sportit, Mirela Karabina, për pezullimin nga detyra të drejtorit të Përgjithshëm të MAS, znj. Ornela Koleka. DAP tha se vendimi për pezullimin e zyrtarëve të MAS nga ana e Ministres së Arsimit është i pavlefshëm dhe është nxjerrë në tejkalim të kompetencave pasi nuk respekton procedurat ligjore. Komisioneri për mbikëqyrjen e shërbimit civil deklaroi se Ministrija e Arsimit dhe Sportit bazuar në ligj, duhet të rikthejë në detyrë znj. Ornela Koleka. Edhe DAP, sikundër KSHC, e cilëson aktin e Ministres absolutisht pa vlerë juridike.*
6. 13/06/2017 - Ministrija teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina, urdhëroi pezullimin e menjëhershëm nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, shtetasit Plarent Ndreca, me urdhrin e Ministrit Nr.7/Extra, për shkak të mospërmbushjes së detyrave funksionale që solli pasoja shumë të rënda në mbarëvajtjen e punës së institucionit.
 - b. *Departamenti i Administratës Publike rrëzoi kërkesën për pezullimi nga detyra të z. Plarent Ndreca. DAP bashkë me shërbimin civil argumentuan se kanë hedhur poshtë urdhrin e Ministres së Arsimit dhe Sportit, Mirela Karabina, për pezullimin nga detyra të drejtorit të Përgjithshëm të MAS, z. Plarent Ndreca. DAP tha se vendimi për pezullimin e zyrtarëve të MAS nga ana e Ministres së Arsimit është i pavlefshëm dhe është nxjerrë në tejkalim të kompetencave pasi nuk respekton procedurat ligjore. Komisioneri për mbikëqyrjen e shërbimit civil deklaroi se Ministrija e Arsimit dhe Sportit bazuar në ligj, duhet të rikthejë në detyrë z. Plarent Ndreca. Edhe DAP, sikundër KSHC, e cilëson aktin e Ministres absolutisht pa vlerë juridike.*
7. 13/06/2017 – Administratori i OSHEE-së, z. Haki Mustafa urdhëroi pezullimin e drejtorit të operatorit për rajonin e Elbasanit, shtetasi Bukurosh Maçi, me motivacionin se mori pjesë në fushatë zgjedhore gjatë orarit zyrtar. Ai u zëvendësua menjëherë nga drejtuesi i komanduar, z. Alfred Mitro. Baza ligjore e pushimit: Neni 153 pika 1,2, neni 154 pika 1 i Kodit të Punës si dhe VKM nr. 473 datë 01/06/2017 pika 2 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017.
8. 13/06/2017 – Administratori i OSHEE-së, z. Haki Mustafa urdhëroi pezullimin e shefit të agjencisë së OSHEE Pukë, shtetasi Ndue Nikolli, i cili u zëvendësua menjëherë nga z. Admir Uruçi. Baza ligjore e pushimit: Neni 153 pika 1,2, neni 154 pika 1 i Kodit të Punës si dhe VKM nr. 473 datë 01/06/2017 pika 2 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017.

Gjithashtu, sipas raportimit të Task-Forcës Qeveritare të ngritur me qëllim monitorimin e veprimtarisë së administratës gjatë fushatës zgjedhore në zbatim të marrëveshjes politike të datës 18.05.2017, në bazë të VKM nr. 473, datë 01.06.2017, pasqyrohen edhe këto dy raste të pezullimeve si mëposhtë, ndërkohë që nga monitorimi i INFOCIP, nuk ekzistojnë informacione mbi këto raste nga Media.

9. Ministria e Shëndetësisë, bazuar në informacionet dhe ankesat e bëra në drejtim të Ministrit për pjesëmarrje aktive në fushatë zgjedhore, referoi në Prokurori dhe mori masë për pezullimin nga detyra për shtetasen Armida Lula, Drejtore e komanduar e Shërbimit spitalor Tepelenë.
10. Ministria e Shëndetësisë, bazuar në informacionet dhe ankesat e bëra në drejtim të Ministrit për pjesëmarrje aktive në fushatë zgjedhore, referoi në Prokurori dhe mori masë për pezullimin nga detyra për shtetasin Pandeli Çunge, Kryeinfermier i shërbimit spitalor Kolonjë.

Shtojca 5 – Procedimet e tjera disiplinore

B. Procedime disiplinore nga puna në rend kronologjik, vleresime paraprake

20/06/2017 - Ministria teknike e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina, dërgoi pranë Komisionit Disiplinor, për shkeljet e përsëritura dhe të bëra publike më parë, të cilat janë regjistruar dhe verifikuar, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj drejtuesve apo përfaqësuesve të institucioneve arsimore, si më poshtë vijon:

1. *Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Kavajë,*
2. *Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Bulqizë,*
3. *Përgjegjës i Zyrës Arsimore Has,*
4. *Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Lezhë,*
5. *Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Kurbin,*
6. *Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Gramsh,*
7. *Drejtori i Shkollës Iballë, Fushë Arrëz,*
8. *Drejtori i Shkollës Gorre, Lushnje,*
9. *Drejtori i Shkollës Nepravishtë, Gjirokastrë,*
10. *Drejtori i Shkollës së Mesme, Gramsh*

11. 22/6/2017 – Ministria teknike e Financave, znj. Helga Vukaj, kërkoi marrjen e masave dhe procedim të menjëhershëm disiplinor për 44 punonjës të administratës, për shkak të thyerjes së urdhërimit për mos angazhimin në zgjedhje. Sipas Ministrisë së Financave, ata cënuan standardin zgjedhor dhe mbajtjen larg të administratës dhe keqpërdorimit politik. Dokumentacioni iu përcoll Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë si dhe FAF sha. Nuk ka informacione mbi identitetin e të personave.

VIII. Referenca të dobishme

¹ Relacion shpjegues, Ligji nr. 89/2017, datë 22.5.2017.

² Ligji nr. 91/2017 “Për një ndryshim në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

³ Ligji nr. 90/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

⁴ Ligji Nr. 89/2017, datë 22.05.2017.

⁵ Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi u shfuqizua Urdhri i Kryeministrit nr. 65, datë 12.05.2017 (“Urdhri 65/2017”) “Për marrjen e masave për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme, pronë e administratës publike, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike të çdo niveli për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 Qershor 2017” .

⁶Material përmbledhës: Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2017, fq. 9.

⁷ Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi u shfuqizua Urdhri i Kryeministrit nr. 65, datë 12.05.2017 (“Urdhri 65/2017”) “Për marrjen e masave për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme, pronë e administratës publike, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike të çdo niveli për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 Qershor 2017” .

⁸Raporti I Ministrit të Arsimit dhe Sporteve, (ANEKSI II), faqe 17, 18, 29.

⁹ Raporti i Ministrit të Arsimit dhe Sporteve , (ANEKSI II), faqe 22.

¹⁰ Raporti i Ministrit të Arsimit dhe Sporteve , (ANEKSI II), faqe 23 dhe 27.